

DATA

[ ]

(1) **[PALA PËR MBËSHTETJE]**

- dhe -

(2) **[PRODHUESI BRE]**

## **MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE**

në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një Impianti Fotovoltaik [me një kapacitet të instaluar minimal te pakten 10 MW (përfshirë) dhe me Kapacitet të Mbështetur deri më 100 MW (përfshirë)] që do të vendoset në [një vendndodhje të zgjedhur nga një Ofertues i Përzgjedhur brenda Republikës së Shqipërisë

## PËRMBAJTJA

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME .....	1
2. FILLIMI, AFATI DHE KUSHTET PARAPRAKE .....	15
3. DETYRIMI PËR ASISTENCË .....	19
4. LINJA E TRANSMETIMIT .....	19
5. KAPACITETI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE PËRFITIMET E GJENERIMIT .....	20
6. NDËRTIMI DHE KOLAUDIMI.....	21
7. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PËRGJITHSHME.....	23
8. DEKLARIMET DHE GARANCITË .....	23
9. KUFIZIMET E TRANSFERIMIT .....	25
10. SIPËRMARRJET E ZHVILLUESIT .....	26
11. ZGJIDHJA.....	26
12. PASOJAT E ZGJIDHJES SË PARAKOHSHME TË MARRËVESHJES.....	29
13. NËNKONTRAKTIMI.....	29
14. SIGURIMI I MARRËVESHJES.....	30
15. SIGURIMET .....	30
16. FORCA MADHORE.....	30
17. VEPRIM MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERTAR.....	31
18. NDRYSHIMI I LIGJIT .....	33
19. TRANSFERIMI I PROJEKTIT PAS ZGJEDHJES.....	34
20. VLERËSIMI I GATISHMËRISË SË TREGUT DHE APLIKIMI I CFD.....	35
21. NJOFTIMET .....	36
22. KONFIDENCIALITETI DHE PUBLICITETI .....	37
23. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE .....	38
24. DISPOZITA TË NDRYSHME .....	39
SHTOJCA 1: IMPIANTI DHE VENDNDODHJA .....	42
SHTOJCA 2: SIGURIMI I MARRËVESHJES .....	43
SHTOJCA 3: OFERTA.....	44
SHTOJCA 4: MARRËVESHJA PËR MBËSHTETJE.....	45
SHTOJCA 5: TESTET E KOLAUDIMIT .....	46
SHTOJCA 6: MARRËVESHJA E LIDHJES .....	47

**KJO MARRËVESHJE** lidhet më date. \_\_/\_\_/\_\_

**NDËRMJET:**

- (1) **[PALA PËR MBËSHTETJE]**, që vepron mbi bazën e [ ] [ e regjistruar nr [ ] [ ] dhe seli [ ], ("**Pala për Mbështetje/Autoriteti Kontraktues**")
- (2) **[BRE PRODHUES]**, një kompani e inkuorporuar në [ ] [ e regjistruar nr [ ] [ ] dhe seli [ ], ("**Shitësi/ofertuesi**")

(Pala për Mbështetje dhe Shitësi referuar secili si "**Palë**", dhe se bashku si "**Palët**").

**PARADHENIE:**

- A Në përputhje me Vendimin nr. 349, i datës 12 qershor 2018 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, i ndryshuar ("**Vendimi 349**"), Autoriteti Kontraktues ka ftuar ofertuesit të dorëzojnë ofertat e tyre për në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e një Impianti Fotovoltaik [me një kapacitet të instaluar minimal te pakten 10 MW (përfshirë) dhe me Kapacitet të Mbështetur deri më 100 MW (përfshirë)] që do të vendoset në [një vendndodhje të zgjedhur nga një Ofertues i Përzgjedhur brenda Republikës së Shqipërisë] ("**Projekti**"), që do të marrin masa mbështetëse;
- B Ofertuesi paraqiti një ofertë detyruese për Projektin me kapacitet të instaluar prej [●] (përfshirë) ("**Oferta**"). Zhvilluesi do të lidhë Marrëveshjen për Mbështetje me një subjekt të caktuar nga Autoriteti Kontraktues **Kapacitet të Mbështetur** deri më [●] dhe i cili do të aplikojë për Periudhën e Tregtimit I përpara një Vlerësimi Pozitiv të Gatishmërisë së Tregut në formën e një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë së shlyer fizikisht që rregullon shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Kapaciteti me një çmim fiks prej [ ] ([ ]) Euro për MWh për Periudhën e Tregtimit II, pas një Vlerësimi Pozitiv të Gatishmërisë së Tregut të njohur nga një Deklaratë e Përbashkët, në formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht-

**ËSHTË RËNË DAKORD:**

**1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME**

- 1.1 Termat e mëposhtëm dhe shprehjet e përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimet përkatëse si më poshtë:

**"Shoqëri e Lidhur"** nënkupton, lidhur me një Palë, një shoqëri, korporatë ose një subjekt tjetër ligjor i cili është:

- (a) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontrollin e asaj Pale (për qëllim të këtij përkufizimi, një "**Shoqëri Mëmë**");
- (b) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontrollin e një Shoqërie Mëmë; ose
- (c) drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontroll të përbashkët me një Shoqëri Mëmë,

*me kusht që "**kontrolli**" të kërkojë pronësinë e shumicës së të drejtave të votimit të partnerëve, të aksionarëve ose anëtarëve (sipas nevojës) ose aftësinë për të ushtruar ndikim dominues në pajtim me një kontratë ose me nenet e statutit të shoqërisë ose me ndonjë dokument të barasvlershëm me të;*

**"Marrëveshja"** ose **"Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit"** nënkupton këtë marrëveshje dhe të gjitha Shtojcat e saj, të cilat do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj, me ndryshimet ose ripërforcimet e duhura herë pas here;

**"Kodi Shqiptar i Rrjetit të Transmetimit"** nënkupton dokumentin për funksionimin e Sistemit Kombëtar të Transmetimit, të operuar nga OST;

**"Legjislacioni i Zbatueshëm"** nënkupton, në lidhje me çdo Palë, çdo akt detyrues ndërkombëtar, çdo dispozitë kushtetuese, Ligj, statut, rregull, rregullore, urdhëresë, traktat, urdhër, dekret, vendim, certifikatë, mbajtje, urdhëresë, regjistrim, licencë, ekskluzivitet, lejim, autorizim, udhëzim, miratim qeveritar, pëlqim ose kërkesë të ndonjë Autoriteti Kompetent që ka juridiksion mbi Palën ose pronën e saj, të zbatueshme në ligj ose në kapital, duke përfshirë interpretimin dhe administrimin e tij nga Autoriteti Kompetent;

**"Kodi i Punës në Shqipëri"** nënkupton Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 për "Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë", me ndryshime;

**"Pagesë Disponueshmërie"** nënkupton sipas rastit:

- (a) për Periudhën e Tregtimit I, Çmimi i Energjisë Elektrike shumëzuar me Prodhimin e Konsideruar të Disponueshëm;
- (b) për Periudhën e Tregtimit II, të ardhurat neto të krijuara nga shitja e Produktit të Konsideruar të Disponueshëm që do të ishte krijuar nga Impianti pa një kufizim të udhëzuar në Tregun e Ditës në Avancë dhe (b) Shumën Diferenciale të Çmimit që do të kishte marrë pa udhëzimet e kufizimit.

**"Oferta"** ka kuptimin që i është dhënë në Pjesën Hyrëse 0;

**"Ofertues"** ka kuptimin e caktuar në pjesën hyrëse të kësaj Marrëveshje;

**"Garancia e Ofertës"** ka kuptimin që i është dhënë në Dokumentat e Procedurës Konkurruese;

**"Vlera Kontabël"** nënkupton [ ];

**"Ditë Pune"** nënkupton çdo ditë tjetër përveç të Shtunës, të Dielës ose çdo dite tjetër që bankat duhet të mbyllën sipas ligjit të:

- (a) vendit të biznesit ku Pala është e detyruar të kryejë një pagesë; dhe
- (b) vendit ku ndodhet Vendndodhja;

**"Kapaciteti"** nënkupton një kapacitet nominal bruto (pllaka) të materialeve fotovoltaike të instaluar dhe kolauduar në Impiant të barasvlershëm me [midis 10MW minimum i instaluar dhe deri në [●] të cilët do të vendosen në [një vendndodhje në Republikën e Shqipërisë të zgjedhur nga Ofertuesi i Përzgjedhur];

**"Kapacitet i Mbështetur"** nënkupton deri në 100 MW (përfshirë) nga Kapaciteti për të cilin kërkohen masa mbështetëse sipas kësaj Marrëveshje.

**"Ndryshim i Ligjit"** nënkupton:

- (a) hyrjen në fuqi të ndonjë Ligji (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve) që nuk është në fuqi në Datën e Nënshkrimit;

- (b) modifikimin, shfuqizimin ose zëvendësimin e ndonjë Ligji pas Datës së Nënshkrimit; dhe
- (c) një ndryshim pas Datës së Nënshkrimit në interpretimin ose zbatimin nga çdo Autoritet Kompetent i çdo Ligji (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve),

por nuk do të përfshijë asnjë nga çështjet e mësipërme për aq sa ato përbëjnë:

- (i) masa korigjuese ose sanksione të ushtruara ligjërisht nga Autoriteti Kompetent si rezultat i ndonjë shkeljeje të Ligjit (duke përfshirë çdo Ligj në fushën e Tatimeve) nga Ofertuesi dhe/ose Zhvilluesi,
- (ii) Zbatimin i drejtpërdrejtë ose miratimin e *acquis* i Komunitetit të Energjisë;

**"Pala Kontraktuese CFD"** do të thotë entiteti i caktuar sipas Legjislacionit të Zbatueshëm për të vepruar si një palë kontraktuese në një Kontratë për Diferencë të shlyer financiarisht, e cila mund të jetë pa kufizim Operatori i Energjisë së Rinovueshme ose ndonjë ent tjetër i caktuar për të marrë këtë rol përkohësisht;

**"Data e Operimit Tregtar"** nënkupton fillimisht orën 00:00 (ora vendore) të datës që vjen menjëherë pas datës në të cilën është kryer Kolaudimi, ose nëse është rënë dakord midis Palëve me shkrim, ditën e parë (I) të muajit që vjen menjëherë pas muajit në të cilin është kryer Kolaudimi dhe sipas ndryshimeve në përputhje me Marrëveshjen për Mbështetje;

**"Data e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar"** nënkupton [njëzet e katër (24)] muaj nga Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve, ose nga Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar sipas dakordësisë në përputhje me Marrëveshjen për Mbështetje;

**"Data e Afatit të Synuar të Operimit Tregtar"** nënkupton [njëzet e katër (24)] muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi, ose një datë e mëvonshme sipas dakordësisë në përputhje me Marrëveshjen për Mbështetje;

**"Kolaudimi"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 6.8 (dhe "i **Kolauduar**" interpretohet në të njëjtën mënyrë me të);

**"Certifikatë Kolaudimi"** nënkupton një vërtetim të lëshuar nga Komisioni i Përbashkët ose Eksperti IPN (sipas rastit), kur:

- (a) testet e Kolaudimit, sipas përcaktimit të mëtejshëm në Shtojcën 5, janë përfunduar në mënyrë të kënaqshme; dhe
- (b) Zhvilluesi i ka siguruar Autoritetit Kontraktues dokumentacionin e nevojshëm për kolaudim;

**"Data e Fillimit të Kolaudimit"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 6.3(a) të kësaj Marrëveshje;

**"Afati i Kolaudimit"** nënkupton kohën nga Data e Fillimit të Kolaudimit deri në Datën e Operimit Tregtar;

**"Autoriteti Kompetent"** nënkupton çdo autoritet, ministri, inspektorat, departament, gjykatë, gjykatë arbitrazhi, agjenci administrative ose komision, ose ndonjë organ tjetër qeveritar, bashkie, administrativ ose ent rregullator, (në secilin rast deri në masën ku secila nga të

mësipërmet ka juridiksion mbi secilën ose të dy Palët, këtë Marrëveshje dhe/ose çështje e kësaj Marrëveshjeje) në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, federal, rajonal, lokal ose tjetër;

**“Procedura Konkurruese”** ka kuptimin e shprehur në Pjesën Hyrëse **Error! Reference source not found.**;

**“Dokumentat e Procedurës Konkurruese”** nënkupton dokumentat e procedurës konkurruese të publikuara nga Autoriteti Kontraktues gjatë Procedurës Konkurruese;

**"Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve"** nënkupton [gjashtë (6)] muaj nga Data e Hyrjes në Fuqi ose një datë tjetër e mëvonshme sipas dakordësisë së Palëve në përputhje me këtë Marrëveshje;

**"Kushtet Paraprake"** nënkupton Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues dhe Kushtet Paraprake të Zhvilluesit;

**"Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake"** nënkupton datën [gjashtëdhjetë (60) ditë pune] nga Data e Nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose një datë tjetër të mëvonshme sipas dakordësisë së Palëve me shkrim;

**"Marrëveshja e Lidhjes"** nënkupton një marrëveshje të lidhur ndërmjet Zhvilluesit dhe OST-së për lidhjen e Impiantit me Rrjetin e Transmetimit ose Marrëveshja ndërmjet Operatorit të Pavarur të Linjës së Transmetimit dhe OST-së, siç është përkufizuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese dhe në shtojcën 6;

**"Sigurimi i Marrëveshjes"** nënkupton garancinë e siguruar ose ofruar nga Zhvilluesi tek Autoriteti Kontraktues si siguri për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje në formën që përmbush kërkesat e përcaktuara në shtojcën 2, të reduktuara me pesëdhjetë për qind (50%) pas Kolaudimit të pesëdhjetë për qind (50%) të Kapacitetit dhe që do t'i kthehet Zhvilluesit nga Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të Kolaudimit të Impiantit;

**"Kontratë për Diferencë" ose "CfD"** nënkupton kontratën e likuiduar financiarisht për diferencat mes një Zhvilluesi dhe Palës Kontraktuese CfD, pjesë e marrëveshjes për mbështetje dhe që do të zbatohen për Periudhën e Tregimit II pas përfundimit të një Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut sipas kushteve të paracaktuara, për pagimin e shpërblimit të ndryshueshëm simetrik në raport me çmimin referencë të tregut në lidhje me energjinë e prodhuar nga Impianti i përzgjedhur, për një kohëzgjatje maksimale prej [pesëmbëdhjetë (15)] vitesh, siç përcaktohet në Dokumentet e Procedurës Konkurruese dhe në shtojcën 4.

**“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, duke vepruar mbi bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 12 qershor 2018 dhe përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme;

**“Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues”** ka kuptimin që i është dhënë në nenin **Error! Reference source not found.**;

**"Kufizim"** do të thotë çdo ngjarje që mendohet se ndodh gjatë çdo intervali të dërgimit kur ka një kufizim të pjesshëm ose të plotë (përfshirë kufizimin në zero prodhim ose mos dërgim) të prodhimit neto të energjisë elektrike të gjeneruar të Impiantit nga nivelet e prodhimit të energjisë elektrike që Impianti do të ishte në gjendje të prodhonte për shkak të një mase ose udhëzimi nga një Autoritet Kompetent ose OST në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm për shkak të një mase ose udhëzimi nga një Autoritet Kompetent ose OST në përputhje me Ligjet në fuqi për (i) menaxhimin e mbingarkesës, (ii) rregullimin e gjenerimit, (iii) sigurinë

dhe besueshmërinë e sistemit të rrjetit (iv) masat e rishpërndarjes, ose (v) çdo masë tjetër e marrë nga OST në përputhje me kodet e rrjetit dhe Legjislacionin e Zbatueshëm.

**"Vendimi 349"** ka kuptimin e dhënë në Pjesën Hyrëse **Error! Reference source not found.**;

**"Prodhimi i Konsideruar si i Disponueshëm"** nënkupton:

- (a) nëse Data e Operimit Tregtar ka ndodhur të paktën një (1) vit përpara datës në të cilën rrethanat që kanë shkaktuar Pagesën e Disponueshmërisë, vëllimi aktual i energjisë elektrike të hedhur nga Impianti në rrjet në periudhën korresponduese të vitit të kaluar në lidhje me të cilën lind detyrimi për të paguar Pagesën e Disponueshmërisë;
- (b) nëse Data e Operimit Tregtar ka ndodhur në më pak se një (1) vit përpara datës në të cilën rrethanat që kanë shkaktuar një detyrim për të paguar Pagesën e Disponueshmërisë, mesatarja ditore e volumit aktual të energjisë elektrike të hedhur nga Impianti në rrjet që nga Data e Operimit Tregtar, e vlerësuar për orë sipas nevojës në lidhje me ditën e parë dhe të fundit në lidhje me të cilën lind detyrimi i Pagesës së Disponueshmërisë;

**"Shuma e Amortizuar e Kapitalit"** nënkupton Shumën e Kapitalit që zvogëlohet në mënyrë lineare nga Data e Operimit Tregtar përgjatë fundit të përvjetorit të 15 (pesëmbëdhjetë) të asaj date;

**"Zhvilluesi"** nënkupton SPV-në e krijuar dhe njoftuar në përputhje me nenin 2.4;

**"Kushtet Paraprake të Zhvilluesit"** ka kuptimin e dhënë në nenin 2.4;

**"Kushtet e Zhvilluesit"** janë kushtet që përcaktohen në nenin 2.12;

**"Kushtet e Zhvillimit"** janë kushtet që përcaktohen në nenin 3.1 (a);

**"Marrëveshja e Drejtpërdrejtë"** nënkupton një marrëveshje të drejtpërdrejtë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, Zhvilluesit, dhe Institucioneve Financiare të cilat ndër të tjera përfshijnë:

- (a) të drejtën e Institucioneve Financiare për të ndërhyrë brenda një periudhe të caktuar për të siguruar që detyrimet e Zhvilluesit janë në përputhje me qëllim parandalimin e ndonjë rrethane që mund të sjellë zgjidhjen e kësaj Marrëveshje nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe/ose të drejtën e Institucioneve Financiare të prokurojnë një detyrë ose një transferim të të drejtave dhe detyrimeve të zhvilluesit sipas kësaj Marrëveshje në disa rrethana të caktuara;
- (b) pranimin nga ana e Autoritetit Kontraktues të çdo pagese apo sigurie tjetër (lidhur me këtë marrëveshje) e kryer nga Zhvilluesi për Institucionet Financiare; dhe
- (c) detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të mos marrë asnjë veprim për të mbyllur, caktuar një administrator ose sanksionuar një rregullim (ose të ngjashme) vullnetar në lidhje me Zhvilluesin pa i dhënë një kohë të caktuar njoftimi Institucioneve Financiare, sipas kushteve të pranueshme nga Zhvilluesi, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, dhe Institucionet Financiare;

**"Zgjidhja e Parakohshme"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 11.1;

**"Data e Zgjidhjes së Parakohshme"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 11.2;

**“Data e Hyrjes në Fuqi”** ka kuptimin e shprehur në nenin 2.9;

**"Çmimi i Energjisë Elektrike"** nënkupton [ ] ([ ]) Euro për MWh;

**"IPN"** nënkupton inxhinierinë, prokurimin, dhe ndërtimi;

**"Kapital"** nënkupton kapitalin e paguar nga apo për llogari të aksionarëve të Zhvilluesit apo të Shoqërive të Lidhur me ato tek Zhvilluesi për aksionet dhe principalin e pagueshëm sipas një huajeje që aksionarët apo Shoqëritë e lidhur me to kanë përkundrejt Zhvilluesit, me kushte tregtare sipas parimit të barazisë së palëve dhe të nënrenditura ndaj çdo borxhi për shumat e huazuara nga Zhvilluesi sipas ndonjë dokumenti financimi;

**"Shuma e Kapitalit"** nënkupton shumën e Kapitalit që Zhvilluesi ka paguar në Datën e Operimit Tregtar;

**“Euro”** nënkupton valutën e ligjshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që kanë miratuar dhe përdorin të njëjtën valutë të vetme nëpërmjet bashkimit monetar në përputhje me traktatin e Bashkimit Evropian, të ndryshuar herë pas here;

**“Ekspert IPN”** ka kuptimin e dhënë në nenin 6.7;

**“Ekspert”** nënkupton ekspertin e caktuar sipas nenit 23.3;

**"Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve"** ka kuptimin e dhënë në nenin 2.15(b);

**"Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake"** ka kuptimin e dhënë në nenin **Error! Reference source not found.**;

**"Impiant"** nënkupton pajisjet fotovoltaike të diellit që gjenerojnë energji elektike dhe infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë dhe linjën e transmetimit të përkohshme me hollësi në shtojcën 1 (por duke përjashtuar asetet e OST-së të vendosura (ose që do të vendosen) dhe Linjën e Transmetimit në Vendndodhje);

**"Pika e Matjes në Kufirin e Impiantit”** nënkupton pikën e matjes të përcaktuar në Marrëveshje ku Zhvilluesi mund të vërë në funksion Pajisjen Matëse për të treguar Prodhimin e Matur nga Impianti që transmetohet në Linjën e Transmetimit;

**"Institucione Financiare"** nënkupton çdo subjekt ligjor që siguron financimin e borxhit ose rir financimin e Zhvilluesit për projektimin, prokurimin, ndërtimin, Operimin dhe mirëmbajtjen e Impiantit dhe për ushtrimin e të Drejtave të Zhvillimit, si dhe pasuesit të tyre të lejuar, duke përfshirë çdo agjent ose administrues për një person ose persona të tillë dhe duke përfshirë një aksionar ose filial të një aksionari;

**"Ngjarje e Forcës Madhore"** nënkupton çdo akt apo ngjarje që:

- (a) ndalon Palën e prekur të kryejë detyrimet e saj në përputhje me Marrëveshjen; dhe
- (b) është jashtë kontrollit të arsyeshëm, dhe jo rezultat i fajit ose neglizhencës, të Palës së prekur; dhe
- (c) Pala e prekur nuk mund të kapërcejë një akt apo ngjarje të tillë me ushtrimin e të gjitha kujdeseve dhe aftësive të arsyeshme (duke përfshirë shpenzimet me shumë të arsyeshme),



duke iu nënshtruar kushteve të mësipërme, "**Ngjarja e Forcës Madhore**" përfshin pa kufizim aktet ose ngjarjet e mëposhtme:

- (i) fenomenet natyrore, të tilla si stuhitë, uraganet, përmytjet, rrufeja, shpërthimet vullkanike dhe tërmetet;
- (ii) shpërthime ose zjarre që lindin nga rrufeja [jashtë parametrave të sistemit mbrojtës të rrufesë të Impiantit] ose shkaqe të tjera që nuk lidhen me veprimet ose mosveprimet e Palës që kërkojnë të lirohen nga performimi;
- (iii) akte të luftës, trazirave publike, protestave, kryengritjeve, sabotimit, epidemive, akteve terroriste, rebelimit;
- (iv) greva ose mosmarrëveshje të forcës punëtore, *me kusht që* një ngjarje e tillë nuk është një Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar ose i shkaktuar vetëm nga punonjësit e Zhvilluesit ose si rezultat i dështimit të Zhvilluesit për të respektuar një marrëveshje kolektive negociimi;
- (v) ndërprerja e pjesshme ose e plotë e operimit të Impiantit ose një pjese të Impiantit gjatë vlefshmërisë së vendimit gjatë një gjendje emergjence për territorin e Republikës së Shqipërisë, ose njësisë vetë-qeverisëse vendore ku ndodhet Impianti; dhe
- (vi) mosarritja apo pamundësia për të arritur rezultate pozitive sipas vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis që kërkohej nga Legjislacioni i Zbatueshëm dhe/apo Shtojca 21 e Dokumentave të Procedurës Konkurruese që nuk rezultojnë nga mospërbushja e kërkesave ligjore të Zhvilluesit në lidhje me to apo nga një sjellje e paligjshme apo në keqbesim nga asnjëra prej Palëve, dhe që në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve do të përcaktohet me ndërmjetësim apo me raportin e ekspertit të Qendrës për Ndërmjetësim dhe Negocim të Komunitetit të Energjisë sipas nenit **Error! Reference source not found.**;

*me kusht që* një Ngjarje e Forcës Madhore nuk përfshin:

- (A) padisponueshmërinë e forcës punëtore, pajisjeve, materialeve, shërbimeve komunale ose burimeve të tjera (me përjashtim të rastit kur padisponueshmëria vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);
- (B) vështirësi ekonomike ose financiare apo mungesë fondesh ose pamundësi për të përmbushur detyrimin për të paguar në afat apo pamundësi për të përfunduar financim;
- (C) mungesë materialeve që nevojiten për zhvillimin, ndërtimin ose mirëmbajtjen e Impiantit (me përjashtim të rastit kur mungesa e materialeve vjen si pasojë e Ngjarjes së Forcës Madhore);
- (D) greva, ngadalësim ose ndërprerje të punës që prek punonjësit e Palëve, Shoqëritë e tyre të Lidhura, ose secilin prej agjentëve ose kontraktuesve përkatës e shkaktuar vetëm nga punonjësit e njëjës Palë ose si rezultat i dështimit të kësaj Palë për të respektuar një marrëveshje kolektive negociimi ose legjislacionin e zbatueshëm për punën; ose
- (E) ndryshime të kushteve në tregun përkatës;

**"Përfitimet e Gjenerimit"** nënkupton të gjitha të drejtat dhe përfitimet e lidhura me lëshimin e garancive të origjinës dhe përjashtimet nga të gjitha kostot apo tatimet, të drejtat e rimbursimit, vlerën e tregut ose të drejta të tjera të Prodhimit Përkatës, sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;

**"Praktika e Mirë e Industrisë"** nënkupton shkallën e aftësive dhe kujdesit që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një kontraktues me përvojë në të njëjtin lloj sipërmarrjesh (projektim, inxhinieri, instalim, ndërtim, kompletim, kolaudim, testim, operim dhe mirëmbajtje) në lidhje me projekte të një madhësie të njëjtë, fushëveprimi, shkallë, natyrë dhe kompleksiteti të ngjashëm me Impiantin;

**"Pika e Matjes në Lidhjen me Rrjetin"** nënkupton pikën e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen e Lidhjes në të cilën rrjedh energjia elektrike dhe ku kryhet matja midis infrastrukturës elektrike të operuar nga Zhvilluesi në Impiant dhe Rrjetin e Transmetimit të operuar nga OST-ja;

**"Rrjeti i Transmetimit"** nënkupton sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes elektrike të poseduara dhe operuara nga OST për shpërndarjen e energjisë elektrike përtej Pikës së Matjes;

**"Plani i Zbatimit"** nënkupton studimin e hollësishëm inxhinierik për Punët që do të ndërmerren për Impiantin, i cili do të dorëzohet nga Zhvilluesi tek Autoriteti Kontraktues për miratim, duke përfshirë hartimin inxhinierik, planet e ndërtimit, kalendarin e ndërtimit, specifikimet e performancës, procedurat e kolaudimit për testimin, inspektimin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e Impiantit;

**"Rasti i Paaftësisë Pagueuse"** nënkupton për sa i përket një Pale, se ajo Palë:

- (a) është shpërbërë (ndryshe nga një konsolidim, bashkim apo shkrirje);
- (b) është e paaftë të paguajë ose nuk mund të paguajë borxhet ose pranon me shkrim paaftësinë e saj në përgjithësi për të paguar borxhet që detyrohet;
- (c) kryen një detyrë, rregullim ose përbërje të përgjithshme me ose për përfitimin e kreditorëve të saj;
- (d) krijon ose ka krijuar kundër saj një procedim që kërkon një gjykim mbi paaftësinë paguese ose falimentimin ose ndonjë masë tjetër lehtësuese sipas ndonjë ligji për paaftësinë paguese ose falimentimin apo ndonjë ligji tjetër të ngjashëm që prek të drejtat e kreditorëve, ose paraqitet një kërkesë për mbylljen apo likuidimin e saj, dhe në rast të ndonjë procedimi të tillë, atë procedim apo kërkesë:
  - (i) resulton në një vendim për paaftësinë paguese apo falimentimin apo paraqitjen e një urdhri lehtësues ose dhënie të urdhrin për mbylljen apo likuidimin e saj; ose
  - (ii) nuk është tërhequr, shkarkuar, liruar, kufizuar ose ka qëndruar në çdo rast brenda [tridhjetë (30)] ditëve të krijimit ose paraqitjes së atij procedimi apo kërkesë;
- (e) ka një zgjidhje për mbylljen e saj, menaxhimin apo likuidimin zyrtar (ndryshe nga një konsolidim, shkrirje apo bashkim);

- (f) kërkon ose është subjekt i caktimit të një administratori, likuidues provizor, ruajtës, marrës, administrator i besuar, kujdestar apo zyrtar i ngjashëm për atë ose për të gjitha asetet apo asetet kryesore;
- (g) ka një palë të siguruar që të marrë në posedim të gjitha asetet ose ato kryesore, ose ka një kthim të pronës, ekzekutim të detyrueshëm, masë të sigurimit të pasurisë, sekuestrim apo një proces tjetër gjyqësor nën sekuestro, nën zbatim apo të ngritur padi ndaj të gjitha asetëve ose asetëve kryesore dhe se pala e siguruar posedon, apo ai proces nuk është tërhequr, pezulluar, anuluar, shtyrë ose kufizuar, për secilin çështje brenda tridhjetë [(30) ditëve] në atë rast; ose
- (h) shkakton ose është subjekt i një rasti lidhur me të, i cili, sipas legjislacionit të zbatueshëm të çdo juridiksioni, ka një efekt të ngjashëm për secilin nga rastet e përcaktuara në pikat (a) deri te (g) (e përfshirë);

**"Autoriteti Lëshues"** nënkupton Autoritetin Kompetent përkatës, përgjegjës për lëshimin e Përfitimit të Gjenerimit;

**"Komision i Përbashkët"** ka kuptimin e shprehur në nenin **Error! Reference source not found.**;

**"Marrëveshja Përfundimtare"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.7;

**"Ligj"** nënkupton (përfshirë për Tatimet):

- (a) çdo ligj (duke përfshirë sistemin juridik që bazohet në precedentë), statut, instrument statutor, rregullore, udhëzim, urdhër, rregull apo normë (në çdo rast) të cdo Autoriteti Kompetent (por, për shmangien e çdo dyshimi, vetëm kur ka forcën e ligjit);
- (b) çdo kusht ose kërkesë tjetër për çdo licence të energjisë elektrike ose çdo autorizim, licence, pëlqim, leje ose miratim tjetër të kërkuar nga çdo Autoritet Kompetent (ose çdo përjashtim nga një kërkesë e tillë);

**"Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar"** ka kuptimin e përcaktuar në nenin **Error! Reference source not found.**;

**"Shkak Material"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 11.4;

**"Aparati Matës"** nënkupton pajisjet matëse të certifikuar nga Autoriteti Kompetent zbatues dhe të instaluar në Impiant për të matur energjinë e prodhuar nga Impianti dhe e shpërndarë në Pikën e Matjes në vendin e specifikuar më hollësisht në Marrëveshjen e Lidhjes;

**"Prodhimi i Matur"** nënkupton sasinë e energjisë elektrike të gjeneruar nga Impianti për cdo orë të matur dhe të furnizuar në Rrjetin e Transmetimit siç tregohet nga Aparati Matës i instaluar në Pikën e Matjes në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen e Lidhjes;

**"Pika e Matjes"** nënkupton Pikën e Matjes në Kufirin e Impiantit;

**"MW"** do të thotë megavat;

**"MWh"** nënkupton megavatorë;

**"MWp"** nënkupton megavat në pik;

**"Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje"** ka kuptimin e dhënë në nenin 3.5;

**"Dëmshtëpërblim Një Vjeçar"** ka kuptimin e dhënë në nenin 17.4(b);

**"Vlerësimi Zyrtar i Kredisë"** nënkupton një vlerësim kredie (lidhur me huanë afatgjatë, të pasiguruar, titull borxhi) nga:

- (a) Standard and Poor's;
- (b) Moody's; ose
- (c) një agjenci vlerësimi alternative ose pasuese e njëres prej sa më sipër, e njohur nga industria (e dakordësuar nga Palët ku një marrëveshje e tillë të mos mbahet ose të vonohet pa arsye);

**"Operim"** nënkupton veprimet e Zhvilluesit lidhur me prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportin dhe shitjen e energjisë elektrike, sipas kësaj Marrëveshjeje;

**"OSHEE"** nënkupton "[Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.]", një shoqëri që rregullohet dhe ekziston në zbatim të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë pasuesit e tij të përgjithshëm dhe përfaqësuesit e autorizuar;

**"OST"** nënkupton "[Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a]", një shoqëri që rregullohet dhe ekziston në zbatim të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, duke qenë poseduesi dhe operuesi i Rrjetit të Transmetimit, duke përfshirë pasuesit e tij të përgjithshëm dhe përfaqësuesit e autorizuar;

**"Palë"** nënkupton, sipas rastit [Bashkimin e Shoqërive][Ofertuesin, kur është vërtetuar Data e Transferimit, Zhvilluesin ose Autoritetin Kontraktues; së bashku **"Palët"**];

**"Kriteret Financiare për Sigurimin e Performancës"** nënkupton normat e EBIT në lidhje me Interesin, Fondet nga Operimet, Huaja e Përgjithshme me Kapitalizimin e Përgjithshëm, dhe Vlera Neto Materiale siç përkufizohet në Marrëveshjen për Mbështetje;

**"Lejet dhe Licencat"** nënkupton çdo pëlqim, leje, licencë, autorizim, miratim ose certifikatë, lëshimi ose rinovimi i të cilave është nën përgjegjësinë e ndonjë autoriteti publik dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

**"Vlerësimi Pozitiv i Gatishmërisë së Tregut"** do të thotë vendimi i marrë nga ERE që përcakton se kriteret e Gatishmërisë së Tregut pas Vlerësimit të Gatishmërisë së Tregut janë përmbushur dhe i cili, kur është e zbatueshme, konfirmohet nga një Deklaratë e Përbashkët e Palëve ose çdo mosmarrëveshje e Palëve për një vendim të tillë zgjidhet në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetje.

**"Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike"** nënkupton marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike, pjesë e Marrëveshjes për Mbështetje, ndërmjet Zhvilluesit dhe Palës Kontraktuese për Mbështetje, e cila do të zbatohet gjatë Periudhës të Tregtimit I për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Impianti për një kohëzgjatje maksimale prej [pesëmbëdhjetë (15)] vitesh, siç përcaktohet në Dokumentet e Procedurës Konkurruese dhe në shtojcën 4;

**"Projekt"** ka kuptimin e dhënë në Pjesën Hyrëse **Error! Reference source not found.**;

**"Kriteret e Kualifikimit"** nënkupton kriteret e përcaktuara në Shtojcën 4, të Dokumenteve të KPK në lidhje me Projektin, duke përfshirë kriteret teknike dhe ekonomike;

**“Vlerësimi i Detyruar i Bankës”** nënkupton:

- (a) në lidhje me vlerësimin e Standard and Poor's, një vlerësim të paktën A- apo i barasvlershëm;
- (b) në lidhje me vlerësimin e Moody's, një vlerësim të paktën A3 apo i barasvlershëm; ose
- (c) në lidhje me një agjenci vlerësimi alternative ose pasuese e njërës prej sa më sipër, ekuivalentja përkatëse (e dakordësuar nga Palët ku një marrëveshje e tillë të mos mbahet ose të vonohet pa arsye);

**"Shpërblimi i Kthimit të Investimit"** nënkupton një shumë të barabartë me  $[\square] [\%]$  në vit dhe Shumën e Amortizimit të Investimit të investuar nga Zhvilluesi, [e përbërë për një periudhë të barabartë me: (i) 18 muaj ose (ii) pjesën e mbetur të afati origjinal të kësaj Marrëveshjeje.

**“Rasti i Revokimit”** nënkupton një rast kur:

- (a) Përfitimi i Gjenerimit është lëshuar, marrë ose akumuluar më herët, dhe si rrjedhojë është revokuar apo deklaruar në kundërshtim me Legjislacionin e Zbatueshëm nga një Autoritet Kompetent ose ndryshe është shfuqizuar;
- (b) çdo transferim i Përfitimit të Gjenerimit është i pavlefshëm ose i pazbatueshëm duke qenë se Përfitimi i Gjenerimit i cili ishte subjekt i transferimit të supozuar është subjekt i një tarife, pengu, barre, ose që pretendohet nga një palë e tretë;
- (c) Autoriteti Lëshues përkatës, Autoritet tjetër Kompetent ose OST refuzojnë të lëshojnë ose të vënë në dispozicion Përfitimin e Gjenerimit (ose nuk lejojnë që të merret ose të akumulohet apo regjistrohet) kur secila Palë beson në mënyrë të arsyeshme se Impianti, energjia elektrike e prodhuar nga impianti, ose secila Palë (sipas rastit) ka të drejtën e Përfitimit të Gjenerimit (ose do të kishte pasur të drejtën nëse secila Palë do të kishte respektuar detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje)); ose

Autoriteti Kompetent përkatës (duke përfshirë Autoritetin Lëshues) ose OST i kërkon përfituesit që të mos përftojë, anulojë apo përdorë Përfitimin e Gjenerimit dhe si rezultat përfituesi nuk ka përftuar Përfitimin e Gjenerimit në datën kur Përfitimi i Gjenerimit mund të përfitohej në mënyrë të arsyeshme;

**"Kërkesë për Kualifikim (KPK)"** nënkupton fazën e parë të Procedurës Konkurruese që konsiston në parakualifikimin e ofertuesve potencial me përvojën e nevojshme teknike, burimet financiare dhe gjendjen ligjore për të dorëzuar një Projekt;

**"Kërkesë për Kualifikim (KPP)"** nënkupton fazën e dytë të Procedurës Konkurruese që konsiston në kërkesën për çdo Ofertues të Para-Kualifikuar për të demonstruar qëndrueshmërinë e vendndodhjes së tij të propozuar dhe për të paraqitur një ofertë financiare;

**"Aplikimi KPK"** do të thotë aplikimi i kualifikimit i dorëzuar dhe kualifikuar nga Zhvilluesi në fazën e KPK;

**"Aplikimi KPP"** nënkupton dorëzimin teknik dhe ofertën financiare të dorëzuar nga Zhvilluesi dhe të përzgjedhur si të suksesshme në fazën e KPP;

**"Rregulla"** ka kuptimin e dhënë në nenin 23.4;

**"Garancitë"** nënkupton çdo siguri që përfshin çdo hipotekë, tarifë, peng, barrë, hipoteke, transferim ose interes sigurie ose ndonjë marrëveshje ose marrëveshje tjetër që ka një efekt të ngjashëm juridik ose ekonomik, të ngjashëm me sa më sipër;

**"Data e Nënshkrimit"** nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Palët;

**"Vendndodhje"** nënkupton vendndodhjen të përzgjedhur nga Zhvilluesi sipas Aplikimit KPP dhe që përshkruhet dhe përcaktohet më tej në shtojcën 1, ku do të ndërtohet Impianti;

**"Prodhimi i Mbështetur"** nënkupton Produktin Përfundimtar të Nominuar të përcaktuar në përputhje me nenin 6.5 dhe 6.6 të Marrëveshjes për Mbështetje me kusht që Marrëveshja për Mbështetje të jetë në fuqi;

**"SPV"** ka kuptimin e dhënë në nenin 2.4(c);

**"Tatim"** nënkupton çdo tatim, taksë, sekuestro, detyrim, honorar ose pagesë tjetër ose tatim i një natyre të ngjashme (duke përfshirë çdo sanksion ose interes të pagueshëm në lidhje me ndonjë paaftësi paguese ose ndonjë vonesë në pagesë të çdo ose të njëjtës) duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat dhe tatimi mbi fitimin;

**"Afat"** nënkupton periudhën që fillon në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe përfundon [pesëmbëdhjetë (15) vjet] pas Datës së Operimit Tregtar;

**"Shuma e Zgjidhjes"** nënkupton:

- (a) të gjithë borxhin e zbatueshëm dhe shlyerjen e interesave, përfshirë të gjitha detyrimet për shlyerjen e parakohshme, për shkeljet, penalizimet, pasojat e kursit të këmbimit që Zhvilluesi i detyrohet Institucioneve Financiare (qofshin këto të lidhura me borxh të vjetër apo të ri, me garanci apo pa garanci) për financimin e Kapacitetit; minus
- (b) çdo të ardhur nga sigurimi para Datës së Zgjidhjes nga Zhvilluesi dhe nuk është shpenzuar për restaurimin e Impiantit; minus
- (c) shuma totale e parave në cash të mbajtura nga ose në emër të Zhvilluesit nga Data e Zgjidhjes, duke përfshirë para cash dhe balancën e llogarisë të çdo depozite të tillë, të letrave me vlerë, llogaritë rezervë dhe të sigurimit;

**"Data e Zgjidhjes"** nënkupton datën e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje në përputhje me afatin e saj;

**"Pala Zgjidhëse"** ka kuptimin e dhënë në nenin 11.1;

**"Periudha e Tregtimit I"** do të thotë një periudhë e Afatit që fillon nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për Mbështetje deri në përfundimin e një Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut të njoftuar Palëve në përputhje me kushtet e përcaktuara në Shtojcën 4;

**"Periudha e Tregtimit II"** do të thotë një periudhë e Afatit që fillon nga përfundimi i një Vlerësimi të Gatishmërisë së Tregut të panjoftuar për Palët në përputhje me kushtet e përcaktuara në Shtojcën 4 deri në fund të Afatit.;

**"Kostoja Totale e Projektit"** nënkupton [ ] EUR;<sup>1</sup>

**"Shuma e Zgjidhjes me Vlerë Tregu"** nënkupton Fitimet minus totalin e Humbjeve dhe Kostove që Pala Zgjidhëse pëson si rezultat i zgjidhjes së Marrëveshjes, për qëllimin e së cilës:

- (a) "Kosto" nënkupton tarifatat e ndërmjetësimit, komisionet dhe kostot dhe shpenzimet e tjera të palëve të treta të pësuara në mënyrë të arsyeshme nga Pala Zgjidhëse ose në përfundimin e ndonjë marrëveshjeje në bazë të së cilës ajo ka mbrojtur detyrimin e saj ose duke hyrë në marrëveshje të reja që zëvendësojnë Marrëveshjen e përfunduar dhe të gjitha kostot e arsyeshme ligjore, kostot dhe shpenzimet e bëra nga Pala Zgjidhëse në lidhje me zgjidhjen e saj të Marrëveshjes;
- (b) "Fitimet" do të thotë një shumë e barabartë me vlerën aktuale të përfitimit ekonomik për Palën Zgjidhëse, nëse ka (përfashtuar kostot), që rezultojnë nga zgjidhja e Marrëveshjes, e përcaktuar në një mënyrë të arsyeshme komerciale; dhe
- (c) "Humbje" nënkupton një shumë të barabartë me vlerën aktuale të humbjes ekonomike për Palën Zgjidhëse, nëse ka (përfashtuar Kostot), që rezultojnë nga zgjidhja e Marrëveshjes nga ana e saj, e përcaktuar në një mënyrë të arsyeshme tregtare.

Në llogaritjen e Shumës së Zgjidhjes, Pala Zgjidhëse do të llogarisë Fitimet dhe Humbjet e saj në Datën e Zgjidhjes së Parakohshme, pa u kërkuar të hyjë në ndonjë transaksion zëvendësimi, ose, nëse kjo datë nuk është praktikisht e arsyeshme, në datën më të hershme pas Datës së Zgjidhjes së Parakohshme.

**"Sjellje e Paligjshme me Dashje"** nënkupton një veprim apo mosveprim të qëllimshëm që devijon nga një veprim i arsyeshëm apo një dispozite e marrëveshjes që kryhet apo nuk kryhet duke ditur apo duke neglizhuar apo duke patur qëllim ardhjen e pasojave të dëmshme, që janë të shmangshme dhe në mënyrë të arsyeshme të parashikueshme;

**"Vlerësimi i Gatishmërisë së Tregut"** nënkupton:

- ≡ krijimi i një burse të energjisë elektrike dhe ofrimi i çmimeve të klerimit nga operatori i bursës së energjisë elektrike, të cilat janë mjaftueshëm të shpeshta dhe të arsyeshme për të shërbyer si çmime referencë të ndryshueshme kundrejt Çmimit të Energjisë Elektrike (si çmim fiks) për të mundësuar shlyerjen financiare duke iu referuar diferencës ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe çmimit fiks;
- ≡ gatishmëria e tregut të ditës në avancë për të ofruar një çmim të arsyeshëm referencë përcaktohet nga një Autoritet Kompetent bazuar në një vlerësim të thelluar të tregut të ditës në avancë, i cili kryhet jo më herët se [dymbëdhjetë (12)] muaj pas krijimit të tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe bazohet në një sërë treguesish kyç,
- ≡ themelimi i Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) për të vepruar si palë kontraktuese e CfD-së në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, si dhe kriteri që masat ligjore dhe financiare për OER të jenë marrë, në veçanti një mekanizëm funksional për vendosjen dhe mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme në në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm [të jetë efektive për një periudhë të paktën 3-mujore përpara zbatimit të CfD];

---

<sup>1</sup> Për t'u përcaktuar në bazë të shifrave të përfshira nga Ofertuesi i Preferuar në Studimin Para-Fizibilitetit të dorëzuar si pjesë e Aplikimit të KPP-së.

**"Marrëveshja për Mbështetje"** nënkupton marrëveshjen për mbështetjen e Projektit sipas Shtojcës 4, që përmban kushte për një Marrëveshje të shlyer fizikisht për Blerjen e Energjisë për Periudhën e Tregtimit I dhe kushtet për një Kontratë për Diferencë të shlyer financiarisht për Periudhën e Tregtimit II.

**"Pala Kontraktuese për Mbështetje"** nënkupton palën kontraktuese të caktuar në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen për Mbështetje për të vepruar si Palë Kontraktuese për Mbështetje në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë të shlyer fizikisht për Periudhën e Tregtimit I, ose si pala kontraktuese CfD në Kontratën për Diferencë e shlyer financiarisht për Periudhën e Tregtimit II, dhe për të cilat vlejné dispozitat e përgjithshme për të gjithë Afatin e kësaj Marrëveshjeje për Mbështetje, në kombinim me termat e PPA përkatëse për Periudhën e Tregtimit I ose me kushtet e CfD-së përkatëse për Periudhën e Tregtimit II.

dhe

**"Punime"** nënkupton të gjitha aktivitetet për planifikimin inxhinierik, ndërtimin dhe kolaudimin e Impiantit në përputhje me Planin e Zbatimit.

1.2 Në këtë Marrëveshje, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe:

- (a) njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas;
- (b) një referencë për një gjini nuk do të përjashtojë gjinitë e tjera;
- (c) fjalët për personat përfshijnë personat fizikë, organet e korporatave, shoqatat dhe partneritetet (pavarësisht nëse ndonjëri prej tyre ka një personalitet të veçantë juridik);
- (d) referenca për çdo dispozitë ligjore do të konsiderohet të përfshijë çdo instrument ligjor, akt nënligjor, rregullore, rregull, legjislacion në zbatim të ose i deleguar ose urdhrat, rregullat dhe rregulloret që janë hartuar në përputhje me to dhe çdo ri-miratim ose ndryshim i mëvonshëm i tyre;
- (e) fjalët "përfshirë", "të tjera", "në veçanti", "për shembull" dhe fjalë të ngjashme nuk do të kufizojnë përgjithësinë e fjalëve të mëparshme dhe do të interpretohen sikur ato të pasohen menjëherë nga fjalët "pa kufizim";
- (f) referencat për "shkrimin" përfshijnë shtypjen, printimin, transmetimin elektronik dhe faksimil dhe mënyrat e tjera të përfaqësimit ose riprodhimit të fjalëve në një formë të dukshme dhe shprehjet që kanë të bëjnë me shkrimin do të interpretohen në përputhje me rrethanat;
- (g) seksionet dhe titujt e shtojcave, përmbajtja dhe ballina janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin ose hartimin e kësaj Marrëveshjeje;
- (h) përveç nëse jepet ndryshe, referencat për nenet dhe shtojcat janë referenca për nenet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje, dhe referencat në çdo shtojcë të paragrafëve, pjesëve dhe anekseve, përveç nëse parashikohet ndryshe, referencat në paragrafët, pjesët dhe anekset e shtojcës ose pjesë të shtojcës në të cilin shfaqen referencat;
- (i) referencat e kësaj Marrëveshjeje janë referenca për këtë Marrëveshje të amenduara ose të ndryshuara herë pas here; dhe
- (j) referenca për ndonjë marrëveshje, kontratë, dokument ose akt do të interpretohet si një referencë e saj sipas ndryshimit, të plotësuar ose rinovuar herë pas here.



1.3 Shtojcat dhe secili aneks dhe shtesë e tyre përbëjnë pjesë të kësaj Marrëveshje.

## 2. FILLIMI, AFATI, KUSHTET PARAPRAKE

2.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe vazhdon deri në mbarimin e Afatit, përveç nëse zgjatet ose është objekt i Zgjidhjes së Parakohshme sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

2.2 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve sipas neneve 3, 4, 5, 6, 7, 11 dhe 12 do të hyjnë në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi.

2.3 Autoriteti Kontraktues do të:

(a) sigurojë që Pala Kontraktuese për Mbështetje do të lidhë Marrëveshjen për Mbështetje, në formën e bashkëngjitur në shtojcën 4;

dhe

(b) do të regjistrojë Marrëveshjen tek Autoriteti Kompetent në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm;

(së bashku "**Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues**").

2.4 Ofertuesi do të:

(a) konfirmojë për Autoritetin Kontraktues me shkrim kufij të e Impiantit brenda Vendndodhjes të zgjedhur nga Ofertuesi sipas Aplikimit të KPP;

(b) paraqesë Sigurimin e Marrëveshjes në mënyrë të arsyeshme dhe të kënaqshme tek Autoriteti Kontraktues;

(c) krijojë Subjektin për Qëllime të Veçanta ("SPV") si një njësi ekonomike e themeluar sipas ligjit shqiptar në të cilin Ofertuesi është aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë kontrollues dhe i dorëzojnë tek Autoriteti Kontraktues kopje origjinale dhe të plota të:

(i) Statutit të Shoqërisë (në formë dhe në substancë të miratuara nga Autoriteti Kontraktues para Datës së Hyrjes në Fuqi) dhe certifikatën e regjistrimit të SPV-së me regjistrin tregtar; dhe

(ii) vendimet e miratuara nga aksionarët e SPV-së që autorizojnë performancën nga ana e SPV-së të kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Mbështetjes;

(d) sigurojë që Zhvilluesi të lidhë Marrëveshjen për Mbështetje me Palën Kontraktuese për Mbështetje,

(së bashku "**Kushtet Paraprake të Zhvilluesit**").

2.5 Në datën e regjistrimit të SPV-së në regjistrin tregtar të Shqipërisë ("**Data e Transferimit**"), të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Ofertuesit sipas kësaj Marrëveshjeje i transferohen Zhvilluesit. Ofertuesi do të:

(a) kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që ky transferim është i vlefshëm dhe i dokumentuar; dhe

- (b) sigurojë që të gjitha kërkesat sipas kësaj Marrëveshje lidhur me Zhvilluesin të përfshihen në mënyrë të duhur në dokumentet përbërëse të SPV-së.
- 2.6 Jo më vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, Autoriteti Kontraktues përmbush Kushtet Paraprake të Autoritetit Kontraktues dhe Ofertuesi plotëson Kushtet Paraprake të Zhvilluesit.
- 2.7 Secila palë do ta informojë Palën Kontraktuese për progresin e saj në përmbushjen e Kushteve Paraprake. Më pas Palët do të takohen për të evidentuar përmbushjen e Kushteve Paraprake dhe do të nënshkruajnë një deklaratë të përbashkët lidhur me të ("**Marrëveshje Përfundimtare**"). Edhe përfaqësuesi i Zhvilluesit do të nënshkruajë Marrëveshjen Përfundimtare.
- 2.8 Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk merr pjesë në takim dhe nuk nënshkruan Marrëveshjen Përfundimtare, *me kusht që* Ofertuesi dhe/ose Zhvilluesi i kanë dërguar një njoftim me shkrim Autoritetit Kontraktues [tridhjetë (30)] Ditë Pune përpara takimit, atëherë Ofertuesi dhe Zhvilluesi kanë të drejtën të nënshkruajnë të vetëm Marrëveshjen Përfundimtare dhe t'ia dërgojnë atë Autoritetit Kontraktues. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk kundërshton me shkrim Marrëveshjen Përfundimtare brenda [tridhjetë (30)] Ditëve Pune nga marrja e saj, do të konsiderohet se Marrëveshja Përfundimtare është pranuar nga Autoriteti Kontraktues. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me përmbushjen e Kushteve Paraprake, Marrëveshjen Përfundimtare dhe/ose Datën e Hyrjes në Fuqi zgjidhet në përputhje me nenin Error! Reference source not found..
- 2.9 Data e nënshkrimit të Marrëveshjes Përfundimtare sipas nenit **Error! Reference source not found.** ose dita pas mbarimit të periudhës së [tridhjetë (30)] Ditëve Pune (kur Autoriteti Kontraktues nuk ka kundërshtuar me shkrim në përputhje me nenin 2.8) do të jetë "**Data e Hyrjes në Fuqi**").
- 2.10 Në rast se Kushtet e vetme Paraprake që nuk janë plotësuar ose hequr dorë në Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake janë Kushtet Paraprake të Zhvilluesit:
- (a) Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje duke njoftuar Ofertuesin [tridhjetë (30)] ditë para;
- (b) pas mbarimit të kësaj periudhe [tridhjetë (30)] ditore, kjo Marrëveshje zgjidhet automatikisht pa nevojën për njoftim të mëtejshëm, përveç nëse të gjitha kushtet e paplotësuara janë përmbushur deri në këtë datë ose Palët kanë rënë dakord me shkrim për të zgjatur Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake ("**Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake**") dhe vlefshmëria e Garancisë së Ofertës është shtyrë deri në Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, në këtë rast kjo Marrëveshje zgjidhet vetëm në Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, vetëm nëse të gjitha kushtet e paplotësuara janë përmbushur përpara Datës së Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake; dhe
- (c) pas zgjidhjes, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë të plotë shumën e Garancisë së Ofertës siç mund të jetë shtyrë deri në Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, shuma e të cilës do të konsiderohet se mbulon të gjitha humbjet, kostot dhe shpenzimet e pësuara ose të shkaktuara Autoritetit Kontraktues në lidhje me zgjidhjen e kësaj Marrëveshje dhe për veprimet e nevojshme për të gjetur një zhvillues alternativ për Impiantin.
- 2.11 Në rast se Kushtet e vetme Paraprake që nuk janë plotësuar ose hequr dorë në Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake janë Kushtet e Autoritetit Kontraktues:

- (a) Zhvilluesi mund të zgjidhë këtë Marrëveshje duke njoftuar Autoritetin Kontraktues brenda [tridhjetë (30)] ditësh;
  - (b) pas mbarimit të kësaj periudhe, kjo Marrëveshje zgjidhet automatikisht pa nevojën për njoftim të mëtejshëm, përveç nëse të gjitha kushtet e paplotësuara janë përmbushur deri në këtë datë ose Palët kanë rënë dakord me shkrim për të zgjatur Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake dhe Garancia e Ofertës është shtyrë deri në Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, në këtë rast kjo Marrëveshje zgjidhet vetëm në Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, përveçse kur të gjitha kushtet e paplotësuara janë përmbushur përpara Datës së Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake; dhe
  - (c) jo më vonë se [dyzet e pesë (45)] Ditë Pune nga zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje, Autoriteti Kontraktues do ti kthejë Zhvilluesit Garancinë e Ofertës, ose Sigurimin e Marrëveshjes, cilëndo prej tyre që është lëshuar.
- 2.12 Sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur nga Data e Hyrjes në Fuqi, por në çdo rast, jo më vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve, Zhvilluesi do:
- (a) do t'i ofrojë Autoritetit Kontraktues një Plan Zbatimi për miratim dhe, sipas rastit, do të rishikojë Planin e Zbatimit nëse Autoriteti Kontraktues, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, refuzon Planin e Zbatimit, me kusht që Autoriteti Kontraktues të shprehi qartë dhe të arsyetojë refuzimin e tij;
  - (b) sipas nenit 3 dhe 4, dhe duke ndjekur kërkesat e KPP, të sigurojë që ka siguruar të gjitha të drejtat e aksesit të nevojshme për instalimin dhe funksionimin e Impiantit;
  - (c) sipas neneve 3 dhe 4, dhe pas ofertës së lidhjes sipas Aplikimit të KPP-së, të nënshkruajë Marrëveshjen e Lidhjes me OST-në;
  - (d) të sigurojë çdo miratim, pëlqim, urdhër, autorizim dhe miratim qeveritar për ndërtimin dhe funksionimin e Impiantit ose siç mund të kërkohej për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes për Mbështetje,
- (së bashku, "**Kushtet e Zhvilluesit**")
- 2.13 Në datën në të cilën Zhvilluesi merr dijeni se një ose më shumë nga Kushtet e Zhvilluesit janë përmbushur, ai do të njoftojë Autoritetin Kontraktues me shkrim dhe do t'i ofrojë Autoritetit Kontraktues prova që tregojnë përmbushjen e tyre, që Autoriteti Kontraktues kërkon në mënyrë të arsyeshme.
- 2.14 Sipas nenit 2.15, nëse Zhvilluesi pengohet të përmbushë një ose më shumë prej Kushteve të Zhvilluesit në ose përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Kushteve për shkak të një ose më shumë prej shkaqeve të mëposhtme:
- (a) si pasojë e një Ndryshimi në Ligj; ose
  - (b) si pasojë e një Ngjarjeje të Forcës Madhore për të cilën ofrohet lehtësim sipas nenit 16; ose

- (c) si pasojë e një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar në përputhje me nenin 17 ose si pasojë e dështimit të Autoritetit Kontraktues për të siguruar që OST-ja të jetë në përputhje me nenin 4.3(c) të Marrëveshjes për Zhvillimit të Projektit;

Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve të Zhvilluesit do të shtyhet në përputhje me nenin 2.15(a).

- 2.15 Palët bien dakord dhe pranojnë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve do të ndryshojë vetëm në rrethanat e mëposhtme:

- (a) kur Zhvilluesi dhe Autoriteti Kontraktues bien dakord bashkarisht me shkrim që një datë tjetër të jetë Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve; ose
- (b) kur Zhvilluesi pengohet të përmbushë një ose më shumë Kushte të Zhvilluesit në ose përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Kushteve në ngjarje ose rrethana që bien në nenin 2.14,

në atë rast data përkatëse do të jetë data e rënë dakord me shkrim nga Palët (në lidhje me një marrëveshje sipas pikës 2.15(a) ose do të shtyhet për një periudhë kohe në përpjesëtim me vonesën për arritjen e Kushteve të Zhvilluesit të prekur nga ngjarje të tilla ose rrethanat, me kusht që një shtyrje e tillë të kufizohet në një maksimum prej [një (1)] viti pas Datës origjinale së Afatit Përfundimtar të Kushteve (në lidhje me zbatimin e pikës 2.14) ("**Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve** "). Në rrethana të tilla referenca në këtë Marrëveshje për Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve do të lexohet si referenca për Datën e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve.

- 2.16 Nëse Data e Fillimit të Kolaudimit nuk ka ndodhur në ose përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar si rezultat i mosplotësisimit të Kushteve të Zhvilluesit nga Zhvilluesi deri në Datën e Afatit Përfundimtar të Kushteve (duke patur parasysh që Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve mund të zgjatet në përputhje me nenin 2.15), atëherë Zhvilluesi do të paguajë Dëmet e Vonesës për çdo ditë (ose një pjesë të ditës) ndërmjet Datës së Afatit Përfundimtar të Kushteve dhe datës së plotësisimit të plotë të Kushteve të Zhvilluesit.

- 2.17 Nëse data e plotësisimit të plotë të Kushteve të Zhvilluesit nuk ndodh brenda gjashtë (6) muajve nga Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve, Autoriteti Kontraktues mund të dërgojë një njoftim për zgjidhje të Marrëveshjes për këto arsye dhe, me dorëzimin e një njoftimi të tillë të Zhvilluesit, Marrëveshja më pas do të përfundojë..

- 2.18 Asgjë në këtë nen nuk do të kufizojë detyrimet e Autoritetit Kontraktues dhe/ose të Palës Kontraktuese për Mbështetëje, ose të drejtat e Institucioneve Financiare, sipas Marrëveshjes Direkte. Në rast mospërputhjeje ndërmjet këtij neni dhe dispozitave të Marrëveshjes Direkte, dispozitat e Marrëveshjes Direkte do të mbizotërojnë.

- 2.19 Çdo mosmarrëveshje ose padakordësi për sa i përket kohëzgjatjes deri në të cilën Data përkatëse e Afatit Përfundimtar të Kushteve duhet të zgjatet sipas nenit 2.15 do të trajtohet në përputhje me nenin 24.

### **3. DETYRIMET PËR ASISTENCË**

- 3.1 Autoriteti Kontraktues, me kërkesën e Zhvilluesit, do t'i ofrojë Zhvilluesit ndihmë të arsyeshme në mënyrë që ai të marrë me kohë nga Autoriteti Kompetent përkatës të gjitha Lejet dhe Licencat dhe të Drejtën e Kalimit të nevojshme për qëllimin e Projektit, duke përfshirë, pa u

kufizuar, rinovimet e tyre. Një ndihmë e tillë nga Autoriteti Kontraktues nuk do të jepet në rast se moslëshimi ose refuzimi i rinovimit të Lejeve dhe Licencave dhe të së Drejtës së Kalimit është rezultat i mospërbushjes së të gjitha kërkesave nga Zhvilluesi sipas Legjislacionit të Zbatueshëm përkatës.

- 3.2 Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë ndihmë të arsyeshme Zhvilluesit në lidhje me çdo marrëdhënie me Autoritetet Kompetente përkatëse përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të nevojshme komunale për Impiantin. Sidoqoftë, Zhvilluesi do të marrë masat e veta në lidhje me sigurimin e ujit, trajtimin të ujërave të zeza dhe energjisë elektrike dhe do të përballojë të gjitha shpenzimet dhe detyrimet në lidhje me to.
- 3.3 Autoriteti Kontraktues do t'i ofrojë ndihmë të arsyeshme Zhvilluesit në lidhje me negociimin dhe përfundimin në kohë të Marrëveshjes së Lidhjes.
- 3.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar që të mos ketë zhvillime të tjera të ndërmarra në afërsi të Vendndodhjes, të cilat mund të kenë ndikim negativ në efikasitetin e Impiantit ose aftësinë e tij për të prodhuar energji elektrike me efikasitet optimal..
- 3.5 Në rast të përcaktimit të një subjekti të ri për të vepruar si palë kontraktuese në Marrëveshjen për Mbështetje në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm në fuqi ("**Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje**"), Autoriteti Kontraktor do të mundësojë që:
  - (a) Pala Kontraktuese për Mbështetje ceduese do të kryejë të gjitha detyrimet e saj sipas Marrëveshjes për Mbështetje derisa Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje të aderojë në Marrëveshjen për Mbështetje si Pala Kontraktuese për Mbështetje;
  - (b) Pala Kontraktuese për Mbështetje ceduese dhe Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje do të mbeten bashkërisht dhe veçmas përgjegjëse ndaj Zhvilluesit për të gjitha detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje që kanë lindur sipas Marrëveshjes për Mbështetje përpara transferimit; dhe
  - (c) pa paragjykuar nenin 14.1 të Marrëveshjes për Mbështetje, në rast dhe për sa kohë që Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje dështon të përmbushë të njëjtat Kriteria Financiare për Sigurimin e Performancës si Pala Kontraktuese për Mbështetje ceduese ose ka një Vlerësim Zyrtar të Kredisë më të ultë se Vlerësimi Zyrtar i Kredisë i Palës Kontraktuese për Mbështetje ë momentin e transferimit të Marrëveshjes për Mbështetje, Pala Kontraktuese për Mbështetje ceduese dhe Pala e Re Kontraktuese për Mbështetje do të mbeten bashkërisht dhe individualisht përgjegjës ndaj Zhvilluesit në lidhje me të gjitha detyrimet e Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas Marrëveshjes për Mbështetje, ërveç nëse Zhvilluesi bie dakord ndryshe me shkrim.

#### **4. LINJA E TRANSMETIMIT**

- 4.1 Zhvilluesi do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të ushtruar të Drejtën e Kalimit për ndërtimin e Linjës së Transmetimit dhe do të kompensojë me shpenzimet e tija në përputhje me

Legjislacionin e Zbatueshëm, dëmet e shkaktuara palëve të treta nga ushtrimi i së Drejtës së Kalimit;

- 4.2 Zhvilluesi projektin dhe ndërton Linjën e Transmetimit me kostot e veta, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Aplikimin KPP dhe sipas kriterëve të Marrëveshjes së Lidhjes;
- 4.3 Me përfundimin dhe kolaudimin e suksesshëm të Linjës së Transmetimit, Zhvilluesi i'a transferon pronësinë e Linjës së Transmetimit OST-së në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen e Lidhjes;
- (a) kur pronësia e Linjës së Transmetimit i transferohet OST-së, sipas këtij neni, Pika e Matjes në Kufirin e Impiantit konsiderohet Pika e Matjes në Lidhjen me Rrjetin;
  - (b) OST-ja është përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e Linjës së Transmetimit, në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe Marrëveshjen e Lidhjes.

## **5. KAPACITETI, ENERGJIA ELEKTRIKE DHE PËRFITIMET E GJENERIMIT**

5.1 Zhvilluesi:

- (a) projektin dhe ndërton impiantin për të arritur Kapacitetin përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar;
  - (b) shet dhe shpërndan Prodhimin Përkatës me Çmimin e Energjisë Elektrike;
  - (c) zbaton detyrimet nën këtë Marrëveshje, Marrëveshjen për Mbështetje në formën e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike për Periudhën e Tregtimit I dhe Kontratën për Diferencë për Periudhën e Tregtimit II, Marrëveshjen e Lidhjes dhe Legjislacionin e Zbatueshëm;
- dhe
- (d) pas përfundimit të Marrëveshjes për Mbështetje, vijon të mundësojë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar në Impiant dhe Kapacitetin për tregun e energjisë elektrike në përputhje me modelin dhe rregullat e tregut sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

5.2 Në marrjen në konsideratë për përzgjedhjen e Ofertuesit gjatë Procedurës së Konkurrimit, sigurimi i mbështetjes për zhvillimin nën këtë Marrëveshje, dhe blerja e energjisë elektrike me Çmimin e Energjisë Elektrike sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike për Periudhën e Tregtimit I dhe Kontratën për Diferencë për Periudhën e Tregtimit II, të gjitha vlerat dhe përfitimet e Përfitimeve të Gjenerimit (duke përfshirë, por pa u kufizuar, në vlerat dhe përfitimet që vijnë si pasojë e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të energjisë së rinovueshme për Prodhimin Përkatës) janë të përfshirë në Çmimin e Energjisë Elektrike. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën ekskluzive të këtyre Përfitimeve të Gjenerimit.

5.3 Në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe sipas udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues, Zhvilluesi nuk do të aplikojë për apo të përfitojë prej Përfitimeve të Gjenerimit të lidhura me Prodhimin Përkatës, apo nëse kërkohen për pajtueshmëri me kufizimet e ndihmës shtetërore të përcaktuar në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, apo të transferojë apo të verë në dispozicion të Autoritetit Kontraktues pa pagesë, barrë, detyrim apo pretendime të palëve të treta të gjitha Përfitimet e Gjenerimit të lidhura me Prodhimin Përkatës dhe Zhvilluesi nuk do të kundërshtojë asnjë të drejtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me:

- (a) ndonjë prej Përfitimeve të Gjenerimit të lidhura me Prodhimin Përkatës; ose

- (b) ofrimin e një pjesë apo të gjitha Përfitimeve të Gjenerimit të lidhura me Prodhimin Përkatës të palëve të treta.

## 6. NDËRTIMI DHE KOLAUDIMI

- 6.1 Zhvilluesi do të ndërmarrë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të prokuruar mjetet e nevojshme që ndërtimi dhe Kolaudimi i Impiantit të kryhet dhe përfundohet në përputhje me të gjithë Legjislacionin e Zbatueshëm, Praktikën e Mirë të Industrisë, Dorëzimin e KPP dhe termat e kushtet e Marrëveshjes për Mbështetje.
- 6.2 Zhvilluesi:
  - (a) do të nisë Punimet brenda [tridhjetë (30)] Ditë Pune nga Data Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake ose nga Data e Shtyrjes së Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, sipas rastit.
- 6.3 Zhvilluesi njofton Autoritetin Kontraktues dhe Palën Kontraktuese për Mbështetje me shkrim për sa më poshtë:
  - (a) parashikimin më të saktë të mundshëm kur pritet të nisë Kolaudimi (data e referuar në këtë njoftim është **“Data e Fillimit të Kolaudit”**) sa më shpejt të jetë praktikisht e mundshme pas përmbushjes së Kushteve të Zhvilluesit;
  - (b) parashikimin më të saktë të mundshëm kur parashikon Datën e nisjes së Operimit Tregtar, sa më shpejtë të jetë praktikisht e mundur; dhe
  - (c) Datën e Operimit Tregtar pa vonesë, kur kjo ndodh.
- 6.4 Gjatë Periudhës së Kolaudit, Zhvilluesi ka të drejtën t’i shesë Palës Kontraktuese për Mbështetje (në kuadrin e Marrëveshjes për Mbështetje), megjithëse Pala Kontraktuese për Mbështetje nuk ka asnjë detyrim të blejë por mund të zgjedhë, përmes një njoftimi drejtuar Zhvilluesit, të blejë dhe të pranojë Prodhimin e Matur të prodhuar nga Impianti. Nëse Pala Kontraktuese për Mbështetje nuk zgjedh të blejë Prodhimin e Matur gjatë periudhës së Kolaudit, Zhvilluesi mund t’ia mundësojë Prodhimin e Matur tregut të lirë të energjisë elektrike në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm. Kjo mund të përfshijë pa kufizim të drejtën e Zhvilluesit të marrë pjesë në procedura konkurruese për shitjen e energjisë elektrike për të mbuluar humbjet e Rrjetit të Transmetimit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm.
- 6.5 Zhvilluesi bën të gjitha përpjekjet e mundshme për të përfunduar ndërtimin dhe Kolaudimin e Impiantit përpara Datës së Synuar të Operimit Tregtar, por Zhvilluesi përfundon ndërtimin dhe Kolaudimin përpara Datës së Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar.
- 6.6 Zhvilluesi njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me përfundimin e punimeve të Impiantit. Brenda [njëzet (20)] ditëve nga marrja e këtij njoftimi nga Autoriteti Kontraktues, Zhvilluesi dhe Autoriteti Kontraktues do të ngrenë një komision të përbashkët të përbërë prej [4 (katër) individësh, dy (2) përfaqësues të Zhvilluesit, dhe dy (2) përfaqësues të Autoritetit Kontraktues] (**“Komisioni i Përbashkët”**), që do të jenë përgjegjës për vlerësimin e testit të Kolaudit dhe lëshimin e Certifikatës së Kolaudit.
- 6.7 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të caktojë [dy (2)] anëtarët e vet në Komisionin e Përbashkët për Kolaudimin e Impiantit, ose nëse anëtarët e tij nuk arrijnë të marrin pjesë në testin e Kolaudit, ose nëse ndodh mospajtueshmëri në Komisionin e Përbashkët lidhur me përcaktimin nëse Kolaudimi është kryer, sipas nenit **Error! Reference source not found.**, Zhvilluesi ka të drejtën të caktojë një Ekspert IPN të pavarur e me reputacion të mirë

(“**Eksperti IPN**”) me shpenzimet e veta, për të kryer testin e Kolaudimit dhe për të lëshuar Certifikatën e Kolaudimit. Certifikata e Kolaudimit dhe një raport i detajuar teknik i gjetjeve të Ekspertit IPN të pavarur i dorëzohen Autoritetit Kontraktues nga Zhvilluesi brenda [dhjetë (10)] ditëve nga data e lëshimit të Certifikatës së Kolaudimit dhe është detyrues për të gjitha Palët.

6.8 “**Kolaudimi**” konsiderohet i kryer kur:

- (a) në Impiant janë instaluar dhe kolauduar mjete prodhimi të barabarta me Kapacitetin dhe është në gjendje të furnizojë një sasi të barasvlershme energjie elektrike në Pikën e Matjes dhe të eksportojë këtë sasi energjie elektrike në Rrjetin e Transmetimit;
- (b) Impianti ka kaluar me sukses të gjitha testimet e besueshmërisë, efijencës dhe disponueshmërisë, që kërkohen zakonisht nga një operator i një impianti të ngjashëm me Impiantin, që vepron në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë;
- (c) lidhja e cila referohet në Marrëveshjen e Lidhjes instalohet dhe futet në sistem energjie për të lejuar eksportin e energjisë elektrike nga Impianti në Rrjetin e Transmetimit;
- (d) Në Impiant është instaluar një Pajisje Matëse; dhe
- (e) Komisioni i Përbashkët ose Eksperti IPN (sipas rastit) ka lëshuar Certifikatën përkatëse të Kolaudimit.

6.9 Sipas nenit 6.10, në rast se Kolaudimi nuk arrihet deri në Datën e Synuar të Operimit Tregtar, Zhvilluesi i paguan Autoritetit Kontraktues dëme të likuiduara ditore në vlerën e [ ] ([ ]) Eurove për MË Kapacitet që nuk është Kolauduar, që fillojnë të përlllogariten Ditën e Punës pas Datës së Synuar të Operimit Tregtar deri në Datën e Operimit Tregtar ose në një datë të Zgjidhjes së Parakohshme, dhe këto dëme të likuiduara do të jenë mjeti i vetëm dhe ekskluziv ligjor mbrojtës i Autoritetit Kontraktues dhe do të konsiderohen se mbulojnë të gjithë kostot dhe shpenzimet e pësuar dhe të përballuara nga Autoriteti Kontraktues për mosrealizimin e Kolaudimit në Datë e Synuar të Operimit Tregtar.

6.10 Palët bien dakord që dëmet e likuiduara të përcaktuara në nenin 6.9:

- (a) nuk paguhen nëse Data e Kolaudimit është penguar ose shtyrë si pasojë e:
  - (i) një ngjarjeje të Forcës Madhore dhe/ose Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar;
  - (ii) një Ndryshimi të Ligjit; ose
  - (iii) nëse Palët bien dakord për një Datë të Synuar të Mëvonshme të Operimit Tregtar për Impiantin dhe
- (b) në asnjë rast nuk do të kalojnë shumën e [pesë përqind (5%)] të Kostos Totale të Projektit.

6.11. Nëse Kolaudimi nuk arrihet përpara ose në Datën e Afatit të Synuar të Operimit Tregtar (subjekt i shtyrjes së datës së afatit të synuar të sipas nenit 2.15 të kësaj Marrëveshjeje ose Data e Synuar e Operimit Tregtar është shtyrë sipas nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje), Autoriteti



Kontraktues do të ketë të drejtën të tërheqë vlerën e plotë të Sigurimit të Marrëveshjes.

## **7. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PËRGJITHSHME**

- 7.1 Autoriteti Kontraktues mund të monitorojë dhe inspektojë ndërtimin e Impiantit gjatë fazës së ndërtimit të përcaktuar në Projekt në prani të një përfaqësuesi të autorizuar të Zhvilluesit, bazuar në një njoftim paraprak të arsyeshëm me shkrim drejtuar Zhvilluesit, për të verifikuar përmbushjen e detyrimeve të Zhvilluesit në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.
- 7.2 Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë mbikëqyrje të përgjithshme të fazës së Operimit të përcaktuar në Projekt në prani të një përfaqësuesi të autorizuar të Zhvilluesit, bazuar në një njoftim paraprak të arsyeshëm me shkrim drejtuar Zhvilluesit, për të verifikuar që cilësia e Punimeve dhe përputhshmëria e tyre i përmbahet Planit të Zbatimit.
- 7.3 Gjatë ndërtimit të Impiantit, në ditën e parë (1-rë) të çdo tremujori (ose në Ditën vijuese të Punës) pas muajit të parë (1-rë) të nisjes së ndërtimit, Zhvilluesi i dorëzon Autoritetit Kontraktues një raport progresi për ndërtimin, ku detajohen:
- (a) zërat e Punimeve të përfunduar dhe atyre në vijim për muajin pararendës (me përjashtim të muajit pararendës të fillimit të fazës ndërtimore);
  - (b) Punimet që priten të përfundojnë gjatë atij muaji;
  - (c) koha e parashikuar për përfundimin e Punimeve;
  - (d) çdo ngjarje apo rrethanë që mund të pengojë apo shtyjë përmbushjen e Datës së Operimit Tregtar; dhe
  - (e) të gjitha çështjet e tjera sipas kërkesës së arsyeshme të Autoritetit Kontraktues.
- 7.4 Nëse hasen pengesa përtej kontrollit të Zhvilluesit që do të sillnin vonesa në kryerjen e Punimeve ose në përmbushjen e Datës së Operimit Tregtar, Zhvilluesi i dorëzon Autoritetit Kontraktues, brenda [dhjetë (10)] Ditë Pune nga identifikimi i pengesës, një raport që detajon arsyet që sollën ose do të sjellin këtë vonesë, dhe masat që do të merren për të shmangur ose minimizuar vonesën në përfundimin e Punimeve brenda Datës së Operimit Tregtar.
- 7.5 Në rast defektesh, mos përmbushjeje detyrimesh, dështimi, ose situatash të ngjashme të identifikuara gjatë monitorimit dhe mbikëqyrjes së përgjithshme të Punimeve, Autoriteti Kontraktues njofton me shkrim Zhvilluesin lidhur me problematikat e identifikuara, masat që do të merren dhe detyrimet që duhen përmbushur për të adresuar dhe korrigjuar këto problematika. Ky njoftim me shkrim përcakton qartë dhe shprehimisht masat që duhet të merren për të lehtësuar problematikat, duke përcaktuar një afat të përshtatshëm lidhur me masat lehtësuese të kërkuara, që duhen korrigjuar nga Zhvilluesi.

## **8. DEKLARIMET DHE GARANCITË**

- 8.1 Autoriteti Kontraktues deklaron dhe garanton që:
- (a) kjo Marrëveshje përben detyrim ligjor të vlefshëm dhe detyruar për të, të ekzekutueshëm ndaj tij në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje, dhe detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje do të jenë ligjërisht detyruese, lidhëse dhe të ekzekutueshme kundrejt tij në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje;

- 8.2 Në Datën e Nënshkrimit, [secili anëtar i Bashkimi të Shoqërive][deri në dhe përfshirë ditën që përbën Datën e Transferimit, dhe nga Data e Transferimit e përgjatë Afatit, Zhvilluesi siguron dhe garanton që:
- (a) është i themeluar në mënyrë të rregullt, të vlefshme dhe në gjëndje të mirë financiare, sipas Legjislacionit të Zbatueshëm;
  - (b) ka pushtet dhe autoritet të plotë për të zbatuar, kryer dhe përmbushur detyrimet e veta në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje;
  - (c) ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin, kryerjen dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje;
  - (d) ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar dorëzimin dhe performancën në përputhje me Aplikimin e KPP-së;
  - (e) zbatimi dhe kryerja e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose përmbushja e detyrimeve të përcaktuara në të nuk shkel asnjë nga:
    - (i) Legjislacionin e Zbatueshëm;
    - (ii) lejet, statutet apo dokumente të tjera të detyrueshme të korporatës; dhe/ose
    - (iii) kontratat e detyrueshme të lidhura prej tij;
  - (f) kjo Marrëveshje përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe detyrues, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj dhe detyrimet e tij në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje janë ligjërisht të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme ndaj tij në përputhje me dispozitat përkatëse;
  - (g) Zhvilluesi dhe secili nga aksionarët direkt ose të tërthortë i janë përmbajtur Legjislacionit të Zbatueshëm në të gjitha aspektet materiale dhe se nuk i është vendosur gjobë, penalitet, vendim gjyqësor, ose përgjegjësi të tjera civile apo penale, të cilat në tërësi kanë ose mund të kenë një ndikim material të pafavorshëm në aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e veta në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje;
  - (h) Zhvilluesi (si SPV) është një subjekt korporatë me qëllim të posaçëm dhe se biznesi në të cilin lejohet të përfshihet është i kufizuar në sa është e nevojshme dhe e volitshme për përmbushjen e përshtatshme të detyrimeve të veta në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje;
    - (i) as Zhvilluesi, apo aksionarët direkt ose të tërthortë nuk janë në proces falimenti, apo likuidimi;
    - (j) as Zhvilluesi, apo aksionarët direkt ose të tërthortë nuk janë dënuar për mashtrim, korrupsion, marrëveshje të paligjshme, pastrim parash, apo vepra penale të kryera gjatë veprimtarisë profesionale;
    - (k) as Zhvilluesi, apo ndonjë prej aksionarëve direkt ose të tërthortë nuk janë përjashtuar apo s'kualifikuar nga procese ofertimi apo prokurimi publik në Republikën e Shqipërisë;
    - (l) as Zhvilluesi, apo ndonjë prej aksionarëve direkt ose të tërthortë nuk janë ndaluar, sipas listës së sanksioneve publike të çdo banke shumëpalëshe zhvillimi që është pjesë e

Marrëveshjes për Zbatimin Reciprok të Vendimit të Ndalimit, datë 9 prill 2010 (www.crossdebarment.org), dhe se asnjë nga subjektet e lartpërmendura nuk janë të përfshira në listat e sanksioneve të hartuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së apo komisionet e tij, ose në listat e njohura ndërkombëtare të sanksioneve, dhe se nuk janë të përfshirë në asnjë mënyrë tjetër në veprimtari (të drejtpërdrejta ose përmes degëve të shoqërisë) që nuk janë në përputhje me sanksionet e hartuara nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së ose komisionet e tij, ose me sanksionet kombëtare në Republikën e Shqipërisë);

- (m) as Zhvilluesi, apo ndonjë prej aksionarëve direkt ose të tërthortë nuk janë në konflikt interesi ose konflikt të mundshëm interesi që lind nga kontrata, marrëveshje, apo marrëdhënie të hershme ose ekzistuese, që ndikojnë ose mund të ndikojnë përfshirjen e tyre të mundshme në Projekt; dhe
- (n) as Zhvilluesi, apo ndonjë prej aksionarëve direkt ose të tërthortë nuk kanë kryer, në kuadrin e Projektit, vepra korrupsioni, mashtrimi, detyrimi, apo akte të tjera që mund të shkelin ndonjërin prej Legjislacionit të Zbatueshëm.

## 9. KUFIZIMET E TRANSFERIMIT

9.1 Zhvilluesi njofton në kohë Autoritetin Kontraktues lidhur me transaksionin e propozuar dhe i paraqet Autoritetit Kontraktues çdo detaj të kërkuar në mënyrë të arsyeshme prej Autoritetit Kontraktues.

9.2 Zhvilluesi merr përsipër që:

- (a) Deri në një datë jo më herët se [tre (3)] vjet nga Data e Operimit Tregtar, çdo anëtar individual i Bashkimit të Shoqërive][Ofertuesi që ka marrë pjesë në përmbushjen e Kriterëve të Kualifikimit, zotëron (drejtpërdrejt apo tërthorazi) të njëjtën përqindje të aksioneve mbi Zhvilluesin si në Datën e Hyrjes në Fuqi; and
- (b) për një periudhë [dymbëdhjetë (12)] vjeçare nga viti i tretë (3-të) i Datës së Operimit Tregtar, çdo transferim i aksioneve të Zhvilluesit, kryhet vetëm me miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues (që nuk do të vonohet apo refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, *për sa kohë që* është e arsyeshme që Autoriteti Kontraktues të refuzojë dhënien e miratimit për transferimin e detyrimeve kur në mënyrë të arsyeshme mendon që cesionari nuk ka kushte financiare apo njohuri teknike të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e transferuesit në këtë Marrëveshje).

9.3 Zhvilluesi mund t'i kalojë të drejtat e tij nën këtë Marrëveshje me anë të Garancive të ose në favor të Institucioneve Financuese pa miratim nga Autoriteti Kontraktues. Zhvilluesi njofton me shkrim Autoritetin Kontraktues për çdo kalim të tillë sa më shpejt të jetë e mundur, por, gjithsesi, përpara transferimit.

9.4 Kur kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Zhvilluesi ose Institucionet Financuese, Autoriteti Kontraktues hyn në një Marrëveshje të drejtpërdrejtë (ose Marrëveshje të Drejtpërdrejtë zëvendësuese, sipas rastit) me Zhvilluesin dhe Institucionet Financuese brenda [tridhjetë (30)] Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Zhvilluesi ose Institucionet Financuese ku i kërkohet Autoritetit Kontraktues të nënshkruajë një Marrëveshje të Drejtpërdrejtë në përputhje me këtë Marrëveshje.

9.5 Zhvilluesi siguron që çdo përfitues ose cesionar i aksioneve të Zhvilluesit apo çdo cesionar i të drejtave ose detyrimeve sipas kësaj Marrëveshje, nën diskrecionin e vetëm të Autoritetit Kontraktues, aderon në këtë Marrëveshje ose nënshkruan marrëveshje apo dokumente që mund

të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, për t'i dhënë efekt të plotë detyrimeve sipas kësaj Marrëveshje.

## 10. SIPËRMARRJET E ZHVILLUESIT

10.1 Nga Data e Hyrjes në Fuqi dhe gjatë gjithë Afatit:

- (a) Zhvilluesi mbetet një “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “Shoqëri aksionare”, që vepron në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- (b) objekti i vetëm i Zhvilluesit është projektimi, ndërtimi, Operimi, dhe mirëmbajtja e Impiantit, duke përfshirë planifikimin, financimin, ndërtimin, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me këtë Marrëveshje; dhe
- (c) Zhvilluesi mban selinë e tij të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

10.2 Brenda [tre (3)] javëve nga Data e Fillimit të Kolaudimit, Zhvilluesi i siguron Autoritetit Kontraktues kopje të vërtetuara të certifikatave të sigurimit që vërtetojnë (sipas kushteve të arsyeshme të Autoritetit Kontraktues) se Zhvilluesi ka marrë të gjitha policat dhe mbulimet e sigurimit në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**

10.3 Zhvilluesi iu përmbahet dispozitave të Kodit Shqiptar të Punës, si dhe të gjitha rregulloreve të sigurimit teknik, disiplinës teknike, mbrojtjes në punë, higjienës dhe sigurisë nga zjarri, me qëllim parandalimin e çdo dëmi apo fatkeqësie në punë.

10.4 Zhvilluesi siguron zbatimin e duhur dhe në kohë të të gjitha masave të sigurisë në impiant, në përputhje me Praktikat e Mira të Industrisë dhe Legjislacionin e Zbatueshëm.

10.5 Zhvilluesi paguan të gjitha shpenzimet dhe kostot që lidhen me aplikimin dhe lëshimin e çfarëdo Licence dhe Leje, si dhe çdo shpenzimi noterial.

10.6 Në rast rifinancimi me një Institucion Financiar pas Datës së Operimit Tregtar rezulton në një vlerë më të madhe të Shumës së Zgjidhjes, Zhvilluesi do të kërkojë miratimin e Autoritetit Kontraktues për kushtet e rifinancimit, veçanërisht për ndryshimet e propozuar në parashikimet që prekin Shumën e Zgjidhjes pas Datës së Operimit Tregtar dhe ky miratim nuk do të mbahet apo nuk do të vonohet në mënyrë të paarsyeshme. Autoriteti Kontraktues brenda [dhjetë (10)] Ditë Pune nga marrja e kërkesës me shkrim të Zhvilluesit do të njoftojë me shkrim Zhvilluesit për pozicionin e tij. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë zgjatje të këtij afati me shkak të arsyeshëm. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk jep përgjigje me shkrim brenda [dhjetë (10)] Ditë Pune nga marrja e kërkesës të Zhvilluesit, do të konsiderohet se ai ka miratuar kushtet e rifinancimit që ka njoftuar Zhvilluesi.

10.7 Ofertuesi që ka marrë pjesë në përmbushjen e Kriterëve të Kualifikimit, do të mbetet bashkarisht dhe solidarisht përgjegjës për këtë Marrëveshje, së bashku me Zhvilluesin, që nga Data e Hyrjes në Fuqi deri në Datën e Operimit Tregtar.

## 11. ZGJIDHJA

11.1 Në rast se ka ndodhur një Shkak Material në lidhje me njërën nga Palët dhe vazhdon, Pala tjetër (“**Pala Zgjidhëse**”) mund të zgjidhë Marrëveshjen (“**Zgjidhja e Parakohshme**”) duke njoftuar Palën Kontraktuese me shkrim.

- 11.2 Njoftimi për Zgjidhjen e Parakohshme duhet të specifikojë Shkakun Material përkatës për Zgjidhjen e Parakohshme dhe përcakton një datë si Datë e Zgjidhjes së Parakohshme (“**Data e Zgjidhjes së Parakohshme**”). Data e Zgjidhjes së Parakohshme nuk mund të jetë më herët se data kur njoftimi konsiderohet si i marrë, sipas Marrëveshjes, dhe jo më vonë se [njëzet (20)] ditë pas kësaj date. Duke filluar nga Data e Zgjidhjes së Parakohshme, të gjitha pagesat dhe përmbushjet e mëtejshme që lidhen me Marrëveshjen shuhen (dhe jo thjesht pezullohen) dhe detyrat dhe detyrimet ekzistuese të Palëve zëvendësohen nga detyrimi i Palës tjetër për t'i paguar Palës Zgjidhëse dëmet për mospërmbushje në shumën (nëse ka) e llogaritur në përputhje me nenin Error! Reference source not found..
- 11.3 Shuma e Zgjidhjes i paguhet Palës Zgjidhëse nga Pala tjetër brenda [gjashtëdhjetë (60)] Ditë Pune nga njoftimi i Palës Zgjidhëse, në përputhje me nenin Error! Reference source not found..
- 11.4 Marrëveshja mund të zgjidhet në çdo kohë për një ose disa nga shkaqet e mëposhtme (ku secili përbën “**Shkak Material**”):
- (a) nga Autoriteti Kontraktues nëse:
    - (i) Marrëveshja për Mbështetje zgjidhet para kohe nga Pala Kontraktuese për Mbështetje për shkak të shkeljes së Marrëveshjes për Mbështetje nga Zhvilluesi;
    - (ii) Zhvilluesi ndodhet në Gjendjen e Paaftësisë Pagueuse ose ndërmerr veprime, të cilat tregojnë pëlqimin, miratimin ose pranimin e tij, për avancimin e Gjendjes së Paaftësisë Pagueuse; ose
    - (iii) Sipas nenit 2.15, Zhvilluesi nuk ka përmbushur Kushtet e Zhvilluesit apo nuk ka realizuar Kolaudimin në Datën e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar;
    - (iv) Zhvilluesi ka kryer një shkelje materiale të një angazhimi, garancie apo deklarimi sipas nenit 8.2 apo nenit 10 që mund të ndreqet (pavarësisht kohës së kryerjes) dhe që Zhvilluesi nuk e ka ndrequr brenda [gjashtëdhjetë (60)] Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Palës Kontraktuese për Mbështetje për ndreqjen e shkeljes përkatëse materiale;
    - (v) Zhvilluesi nuk respekton kushtet materiale të një vendimi arbitrazhi sipas nenit 23;
    - (vi) Zhvilluesi ka kryer një shkelje materiale të kufizimeve të transferimit sipas nenit 9 që Zhvilluesi nuk e ka ndrequr brenda [gjashtëdhjetë (60)] Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Palës Kontraktuese për Mbështetje për ndreqjen e shkeljes përkatëse materiale;
    - (vii) në rast se gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme të Punimeve identifikohet një defekt, mospërmbushje, moskryerje apo të ngjashme dhe Zhvilluesi nuk ndreq këto probleme të identifikuar apo nuk merr masat sipas nenit 7 brenda gjashtëdhjetë (60) Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Palës Kontraktuese për Mbështetje për ndreqjen e shkeljes përkatëse materiale;
    - (viii) Zhvilluesi nuk ka paguar një shumë të pagueshme dhe të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje brenda [tridhjetë (30)] Ditë Pune nga marrja e njoftimit nga Autoriteti Kontraktues për pagimin e shumës së papaguar;

- (ix) Zhvilluesi është i përfshirë në një Sjellje të Paligjshme me Dashje (apo shkakton dëm mjedisor sipas Legjislacionit të Zbatueshëm apo ka kryer një shkelje materiale të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje e cila është e ndreqshme por që Zhvilluesi nuk e ka ndrequr brenda [gjashtëdhjetë (60)] Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për ndreqjen e shkeljes përkatëse materiale;
- (b) nga Zhvilluesi nëse:
- (i) Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike gjatë Periudhës së Tregtimit I ose Kontrata për Diferencë gjatë Periudhës së Tregtimit II është zgjidhur nga Zhvilluesi për shkak të shkeljeve të vazhdueshme nga ana e Palës Kontraktuese për Mbështetje (apo ndonjë Blerësi të Ri, nëse bëhet e zbatueshme) të detyrimeve të pagesës, *me kusht që* pagesat e pashlyera nuk mund të realizoheshin nga Zhvilluesi duke tërhequr këto shuma nga mbështetja e kredisë të dhënë nga apo në emër të Palës Kontraktuese për Mbështetje sipas Marrëveshjes për Mbështetje;
  - (ii) Pala Kontraktuese për Mbështetje ose Pala tjetër i ka transferuar Marrëveshjen për Mbështetje tek një shoqëri që nuk përmbush të njëjtin Vlerësim Zyrtar të Kredisë ose Kriteret Financiare të Sigurimit të Përformancës sikundër Blerësi fillestar sipas Marrëveshjes për Mbështetje dhe Pala Kontraktuese për Mbështetje fillestare nuk ka përgjegjësi solidare sipas nenit 3.6 të kësaj Marrëveshjeje dhe këtë shkelje, Autoriteti Kontraktues nuk e ka ndrequr brenda gjashtëdhjetë (60) Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim të Zhvilluesit për ndreqjen e shkeljes përkatëse materiale;
  - (iii) Autoriteti Kontraktues është në shkelje materiale të një angazhimi, garancie apo deklarimi sipas nenit 3.5 ose nenit 8.1, që mund të ndreqet (pa marrë parasysh kohën e kryerjes) dhe të cilën Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur ta ndreqë brenda gjashtëdhjetë (60) Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Zhvilluesi për Kontraktues për ndreqjen e shkeljes materiale përkatëse;
  - (iv) Autoriteti Kontraktues nuk ka paguar një shumë të pagueshme dhe të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje brenda tridhjetë (30) Ditë Pune nga marrja e njoftimit për pagimin e shumës së papaguar nga Zhvilluesi;
  - (v) Autoriteti Kontraktues është i përfshirë në një Sjellje të Paligjshme me Dashje apo ka kryer një shkelje materiale të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe e cila është e ndreqshme por që Autoriteti Kontraktues ose çdo Autoritet tjetër Kompetent nuk e ka ndrequr brenda gjashtëdhjetë (60) Ditë Pune nga marrja e njoftimit me shkrim nga Zhvilluesi për ndreqjen e sjelljes përkatëse të qëllimshme apo të shkeljes përkatëse materiale; ose
  - (vi) ka ndodhur një ngjarje që lejon zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje për shkak të një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar, siç përcaktohet në nenin 17.2.
- 11.5 Të drejtat e Autoritetit Kontraktues për të zgjidhur këtë Marrëveshje i kalojnë dhe janë subjekt i të drejtave të tjera në favor të Institucioneve Financuese, të cilat përcaktohen në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë, që mund të jenë të zbatueshme për sa i takon Impiantit.
- 11.6 Autoriteti Kontraktues njofton Institucionet Financuese me shkrim nëse parashikon se do të ndër marrë veprime mbështetur në nenin 11 duke dhënë detajet e kërkuara sipas dispozitave të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.

## 12. PASOJAT E ZGJIDHJES SË PARAKOHSHME TË MARRËVESHJES

12.1 Pala Zgjidhëse përlogarit një shumë, që do të paguhet nga Pala tjetër duke llogaritur humbjen e saj në përputhje me dispozitën e nenit 12.

12.2 Sipas nenit 6.11 nëse Zhvilluesi zgjidh këtë Marrëveshje në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**4 (b), Zhvilluesi mund t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues t'i paguajë Zhvilluesit:

(a) një shumë në vlerën e Shumës së Zgjidhjes plus Shpërblimit të Kthimit të Investimit, kundër transferimit të Impiantit dhe të drejtave të tjera të ndërlidhura te Autoriteti Kontraktues

ose

(b) një shumë e barabartë me një Shumë të Zgjidhjes me Vlerë Tregu. Në një rast të tillë, Zhvilluesit i jepet e drejta të mbajë dhe të vazhdojë funksionimin e Impiantit, me kusht që përfitimi ekonomik që rezulton prej tij të llogaritet në Shumën e Zgjidhjes me Vlerë Tregu.

(c) minus çdo kompensim për zgjidhjen e marrë sipas Marrëveshjes për Mbështetje.

12.3 Nëse Autoriteti Kontraktues zgjidh këtë Marrëveshje në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**, Autoriteti Kontraktues mund të zgjedhë që t'i kërkojë Zhvilluesit:

(a) të transferojë Vendndodhjen dhe Impiantin tek Autoriteti Kontraktues në përputhje me nenin 19 dhe t'i njohë Zhvilluesit pagesën e një shumë në vlerën e Shumës së Zgjidhjes, ose;

(b) sipas nenit 16 dhe nenit 17, dhe t'i paguajë Autoritetit Kontraktues:

(i) një shumë që Autoriteti Kontraktues konsideron në mënyrë të arsyeshme në mirëbesim dhe sipas Praktikës së Mirë të Industrisë, si shuma e humbjeve dhe kostove totale të Autoritetit Kontraktues për të prokuruar një kontraktor tjetër për ngritjen e një impianti prodhues të ngjashëm me Impiantin ose

(ii) një shumë që Autoriteti Kontraktues e përcakton në mënyrë të arsyeshme të jetë një Shumë e Zgjidhjes me Vlerë Tregu nga humbja nga ndërprerja e prodhimit të Impiantit me Çmimin e Energjisë Elektrike, plus tarifatat e arsyeshme dhe të posaçme ligjore dhe shpenzimet nga xhepi.

minus çdo kompensim për zgjidhjen e marrë sipas Marrëveshjes për Mbështetje.

12.4. Pala Zgjidhëse i njofton Palës tjetër Shumën e Zgjidhjes, duke përfshirë informacion të hollësishëm për mënyrën e përlogaritjes së Shumës së Zgjidhjes. Pala Zgjidhëse nuk është e detyruar të lidhë marrëveshje zëvendësimi në mënyrë që të përcaktojë vlerën e Shumës së Zgjidhjes. Zgjidhja e Parakohshme nuk i heq Zhvilluesit apo Autoritetit Kontraktues asnjë nga detyrimet e lindura para Datës së Zgjidhjes apo detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, të cilat mbeten në fuqi shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar pas Zgjidhjes së Parakohshme.

## 13. NËNKONTRAKTIMI

13.1 Zhvilluesi ka të drejtë të nënkontrakttojë për kryerjen e Punimeve dhe Operimin e Impiantit, si

dhe për çdo marrëveshje tjetër në lidhje me Impiantin. Zhvilluesi ka detyrim të përbushë të gjitha kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve të KPP dhe duhet të sigurojë që kjo do të arrihet edhe nga nënkontraktorët e propozuar ose të caktuar. Zhvilluesi i siguron Autoritetit Kontraktues informacionin e mëposhtëm në lidhje me nënkontraktorin e propozuar:

- (a) emrin dhe adresën; dhe
- (b) qëllimin e kontraktimit të nënkontraktuesit të propozuar, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nënkontraktuesi i propozuar;

13.1 Autoriteti Kontraktues nuk është përgjegjës për asnjë detyrim të Zhvilluesit kundrejt nënkontraktuesve, furnitorëve dhe palëve të treta, duke përfshirë mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet tyre dhe Zhvilluesit.

#### **14. SIGURIMI I MARRËVESHJES**

14.1 Në Datën e Hyrjes në Fuqi, si garanci për përbushjen e të gjithë detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes (qoftë nëse është sanksionuar nga pagesa e dëmeve të likuiduara ose tjetër) Zhvilluesi i mundëson Autoritetit Kontraktues Sigurimin e Marrëveshjes, në formën e përcaktuar në shtojcën 2. Sigurimi i Marrëveshjes lëshohet nga një bankë ndërkombëtare me reputacion të mirë me të paktën një Vlerësim Zyrtar Krediti të barabartë me ose më të lartë se Vlerësimi i Kërkuar Bankar.

14.2 Jo më vonë se [dyzet e pesë (45)] Ditë Pune nga Kolaudimi i Impiantit ose nga data e zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje për shkak të Forcës Madhore në përputhje me nenin 16, Autoriteti Kontraktues ia kthen Sigurimin e Marrëveshjes Zhvilluesit.

#### **15. SIGURIMET**

15.1 Zhvilluesi, në çdo kohë, do të marrë, mbajë dhe rinovojë çdo sigurim që kërkohet nga Praktika e Mirë e Industrisë dhe Legjislacioni i Zbatueshëm për ushtrimin e të drejtave të tij dhe do të dorëzojë (ose mundësojë dorëzimin) e kopjeve të vërtetuara të çdo policë sigurimi tek Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të arsyeshme të Autoritetit Kontraktues.

15.2 Në rast të dëmtimit të Impiantit apo Vendndodhjes gjatë ndërtimit Operimit të Impiantit, shuma e dëmshpërblimit nga sigurimi përdoret nga Zhvilluesi për të rindërtuar, riparuar dhe/ose rikthyer në gjendjen në të cilën objekti ndodhej përpara dëmtimit.

15.3 Zhvilluesi siguron përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë dhe përcakton si përfitues të përbashkët Autoritetin Kontraktues në të gjitha policat e sigurimit.

#### **16. FORCA MADHORE**

16.1 Sipas pikës 16.2, një Ngjarje e Forcës Madhore nuk i jep asnjëherë nga Palëve të drejtën që të zgjidhë këtë Marrëveshjeje dhe asnjë nga Palët nuk do të jetë në shkelje me këtë Marrëveshjeje, apo përgjegjëse, në rast dështimi për përbushjen të detyrimeve të tyre apo vonese, për sa kohë që ky dështim apo vonesë në përbushjen e detyrimeve ka ndodhur për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore.

16.2 Pala e cënuar nga Forca Madhore do të përfitojë lehtësimin në bazë të nenit 16.1 vetëm nëse:

- (a) ka njoftuar me shkrim menjëherë me shkrim Palën Kontraktuese, për ngjarjen e Forcës Madhore, duke treguar se Forca Madhore në fjalë ka penguar apo vonuar në mënyrë të



arsyeshme përmbushjen e detyrimeve të Palës së prekur dhe duke deklaruar masën e parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Forcës Madhore në fjalë;

- (b) ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zvogëluar ndikimin dhe zbutur pasojat e Forcës Madhore sa më shpejt të jetë e mundur; dhe
  - (c) i paraqet Palës tjetër një raport (apo një plan rekuperimi dhe rehabilitimi në rast epidemie apo kufizime të lidhura që prekin Impiantin), në lidhje me masat e marra në përputhje me nenin 16.2(b) dhe një përditësim të këtyre raporteve rregullisht për sa është e nevojshme në lidhje me zgjatjen parashikuar dhe kohëzgjatjen e mundshme të Ngjarjes së Forcës Madhore dhe në rast epidemie apo kufizime të lidhura, një raport për masat zbutëse dhe të rekuperimit që janë marrë për kalimin e efekteve negative.
- 16.3 Sipas nenit 16.5, secila nga Palët mund ta zgjidhë në mënyrë të menjëhershme këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit me shkrim ndaj Palës tjetër nëse një Ngjarje e Forcës Madhore pengon Palën e prekur që të përmbushë detyrimet nën këtë Marrëveshje për një periudhë vijuese, më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.
- 16.4 Sipas nenit 16.3, Afati (ashtu edhe datat përkatëse të ndërmjetme si Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake, Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve, Data e Afatit Përfundimtar të Operimit Tregtar, Data e Fillimit të Kolaudimit, Data e Operimit Tregtar, Data e Synuar e Operimit Tregtar) do të zgjatet ditë pas dite kur njëra nga Palët pezullon detyrimet e veta nën këtë Marrëveshje për shkak të një ngjarjeje të Forcës Madhore sipas nenit 16.
- 16.5 Në rastin kur Zhvilluesi është Pala e prekur nga Ngjarja e Forcës Madhore dhe kur Ngjarja e Forcës Madhore në fjalë kufizon Kapacitetin e Impiantit, Autoriteti Kontraktues mund ta zgjidhë këtë Marrëveshje vetëm nëse Zhvilluesi, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, nuk arrin ta rikthejë Impiantin në gjendjen fillestare përgjatë një periudhe [dymbëdhjetë (12)] mujore të njëpasnjëshme menjëherë pas Ngjarjes së Forcës Madhore.

## 17. VEPRIM MATERIAL I PAFAVORSHËM QEVERITAR

- 17.1 Zhvilluesi mund të kërkojë që Autoriteti Kontraktues të korrigjojë çdo Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar në përputhje me nenin Error! Reference source not found..
- 17.2 **"Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar" nënkupton:**
- (a) shpronësimin, sekuestrimin, konfiskimin ose shtetëzimin e Impiantit dhe/ose të Drejtave të Zhvillimit;
  - (b) ndalimin ose kufizimin mbi rimarrjen e kontrollin ose transferimin e përfitimeve dhe fitimeve të Zhvilluesit dhe shërbimet e borxhit nga Republika e Shqipërisë (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet e shkëmbimit valutor);
  - (c) çdo detyrim apo Ndryshim në Ligj që do të bënte Legjislacionin e Zbatueshëm, këtë Marrëveshje ose Marrëveshjen për Mbështetje më të ashpër në krahasim me detyrimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Traktatit për Komunitetin e Energjisë apo çdo traktati tjetër ndërkombëtar dhe çdo instrumenti zbatues, lidhur substancialisht me të njëjtën çështje;
  - (d) mos-përmbushja, nga ana e Autoritetit Kontraktues, të kushteve materiale të një vendimi të arbitrazhit në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.;**

- (e) çdo Kufizim i pjesshëm ose i plotë i prodhimit në Impiant, *me kusht* që një Kufizim i tillë të ketë ardhur si rezultat i një urdhri të detyrueshëm sipas Legjislacionit të Zbatueshëm nga një Autoritet Kompetent ose personi të autorizuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për dhënien e një urdhri të tillë, *me kusht* që ky kufizim të mos jetë ekzistues në rastet e mëposhtme:
- (i) dështim nga ana e Zhvilluesit për të mirëmbajtur Impiantin dhe për ta mbajtur atë në sistem energjie në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, Marrëveshjen e Lidhjes apo kërkesat e një Autoriteti Kompetent;
  - (ii) defekte mekanike apo të pajisjeve në Impiant (duke përjashtuar rastin kur këto defekte vijnë si shkak i një Ngjarje të Forcës Madhore);
  - (iii) defekt në projektim, cilësinë e punës, pajisje ose elementë të tjerë të Impiantit; ose
  - (iv) kushte për shkak të përdorimit dhe amortizimit normal;
- (f) veprim ose mosveprim nga një Autoritet Kompetent që sjell pavlefshmërinë apo shuarjen, refuzimin e kërkesës për lëshim, ndryshim dhe zgjatje, brenda afateve të përcaktuara, të ndonjë licence, lejeje, miratimi apo autorizimi tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve apo ushtrimin e të drejtave sipas kësaj Marrëveshjeje, për arsye të cilat nuk kanë të bëjnë me veprimtari të jashtëligjshme apo keqdashëse nga asnjëra prej Palëve;
- (g) veprim i jashtëligjshëm apo dështim për të vepruar nga ana e OST-së (duke përfshirë nënshkrimin e Marrëveshjes së Lidhjes) që nuk vjen për shkak të veprimit, mosveprimit apo dështimit të Zhvilluesit për të përmbushur detyrimet e tij nën këtë Marrëveshje ose, sipas rastit, Marrëveshjen e Lidhjes, apo për t'iu përmbajtur Legjislacionit të Zbatueshëm dhe që shkakton një vonesë që sjell, apo mund të sjellë, vonesën e realizimit të Kolaudit apo Datës së Operimit Tregtar; ose
- (h) dështim nga ana e Autoritetit Kontraktues për të siguruar që Vlerësimi i Gatishmërisë së Tregut dhe aplikimi i Periudhës të Tregtimit I dhe II do të ndodhë në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në nenin **Error! Reference source not found.**,

dhe që ndikon në mënyrë materiale dhe të pafavorshme në aftësinë e Zhvilluesit për të ushtruar, respektuar ose kryer ndonjë nga të drejtat dhe detyrimet sipas Marrëveshjes ose që ndikon në ligjshmërinë, vlefshmërinë, natyrën detyruese ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje.

- 17.3 Nëse Zhvilluesi mendon në mënyrë të arsyeshme se ka ndodhur ose pritet të ndodhë një Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar, Zhvilluesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues dhe të sigurojë informacion të detajuar në lidhje me Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar dhe mënyrën si ndikon materialisht dhe është i pafavorshëm për Zhvilluesin për të drejtat e tij ose për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
- 17.4 Brenda [tridhjetë (30)] Ditë Pune nga njoftimi drejtuar Autoritetit Kontraktues, Palët do të takohen, diskutojnë dhe vendosin në mirëbesim një zgjidhje të kënaqshme reciproke, me qëllim që të rivendosin Zhvilluesin në pozicionin tregtar që do të kishte nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur ose në një pozitë tregtare të barasvlershme. Nëse Palët vendosin se nuk mund të gjendet një zgjidhje e kënaqshme për të adresuar ndikimin e Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, atëherë do të vepohet si vijon:

- (a) nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ndodh para Datës së Operimit Tregtar dhe zgjat deri në [një (1)] vit, Data e Afatit Përfundimtar Tregtar do të shtyhet automatikisht ditë pas dite për sa kohë zgjat Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar;
- (b) nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ndodh pas Datës së Operimit Tregtar dhe zgjat deri në [një (1)] vit, dhe Zhvilluesi nuk është në gjendje të marrë kompensim të barabartë me një pagesë të disponueshmërisë sipas Marrëveshjes së Lidhjes ose ndonjë marrëveshje tjetër me OST-në [brenda 60 (gjashtëdhjetë) Ditëve Pune] me kërkesë me shkrim drejtuar OST-së, Autoriteti Kontraktues i paguan Zhvilluesit një shumë në vlerën e Pagesës së Disponueshmërisë në lidhje me Prodhimin e Konsideruar si të Disponueshëm gjatë periudhës nga data e ngjarjes së Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar deri në [vitin e parë (1-rë)] të tij (“**Dëmshpërblimi Njëvjeçar**”). Për të shmangur dyshimin, çdo Pagesë e Disponueshmërisë sipas kësaj Marrëveshjeje do të zbritet nga çdo kompensim i marrë për të njëjtën periudhë shlyerjeje për të njëjtin Kufizim sipas çdo marrëveshjeje tjetër me OST-në ose Palën Kontraktuese për Mbështetje.
- (c) nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ndodh gjatë Afatit dhe, sipas mendimit të arsyeshëm të Zhvilluesit, është me natyrë të përhershme, Zhvilluesi ka të drejtën të zgjidhë këtë Marrëveshje në përputhje me nenin 11.4 dhe të dëmshpërblehet në përputhje me nenin 12.2;
- (d) nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar ndodh gjatë Afatit dhe zgjat më shumë se [një (1)] vit:
  - (i) Zhvilluesi ka të drejtën të marrë Dëmshpërblimin Njëvjeçar; dhe
  - (ii) pas [vitit të parë (1-rë)] nga ngjarja e Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar, Zhvilluesi ka të drejtën të zgjidhë këtë Marrëveshje në përputhje me nenin 11.4 dhe të dëmshpërblehet në përputhje me nenin 12.2.

17.5 Me ngjarjen e Veprimit Material të Pafavorshëm Qeveritar, Zhvilluesit nuk i hiqet detyrimi për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç rastit kur e bën të paligjshëm ose të pamundur që Zhvilluesi të ushtrojë të drejtën apo të përmbushë detyrimin e prekur.

17.6 Nëse një ngjarje apo rrethanë, që mund të konsiderohet që përbën apo që shkakton një Ngjarje të Forcës Madhore, përbën Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar, do të trajtohet si Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar dhe nuk përbën Ngjarje të Forcës Madhore.

## 18. NDRYSHIMI I LIGJIT

18.1 Nëse ndonjëra nga Palët gjykon se ka ndodhur një Ndryshim i Ligjit që:

- (a) bën zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të pamundur ose të paligjshme;
- (b) bën të pamundur konstatimin e çdo çështjeje materiale që kërkohet të konsiderohet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) bën që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të jenë në kundërshtim me Legjislacionin e Zbatueshëm (duke përfshirë çdo fjalë ose shprehje të kësaj Marrëveshjeje që përcaktohet duke iu referuar kuptimit të saj në Legjislacionin e Zbatueshëm);
- (d) përfshin, zëvendëson, ndryshon apo shuan një Përfitim Gjenerimi apo nëse Rasti i Revokimit ka ndodhur si shkak i një Ndryshimi të Ligjit;

- (e) (pa paragjykuar nenet 18.1(a) deri 18.1(d) më sipër) ndikon në mënyrë të konsiderueshme dhe negativisht në përfitimet e kësaj Marrëveshjeje për ndonjërin apo të dyja Palët,

atëherë kjo Palë mund të njoftojë Palën tjetër duke kërkuar që Palët të takohen për të diskutuar rrethanat e tilla dhe në mirëbesim të përqipen të bien dakord për ndryshimet që duhet të bëhen në këtë Marrëveshje, të nevojshme për të arritur (sa më shumë të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, detyrimeve, rreziqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje sikurse kërkohet në Datën e Hyrjes në Fuqi.

- 18.2 Në qoftë se Palët nuk bien dakord sipas nenit 18.1, secila Palë ka të drejtë ta dërgojë çështjen në Qendrën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe Negocimit në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për përcaktimin e ndryshimeve që duhet t'i bëhen kësaj Marrëveshjeje, që janë të nevojshme për të arritur (sa më shumë të jetë e mundur) të njëjtin ekuilibër të përfitimeve, përgjegjësi, rreziqeve dhe shpërblimeve ndërmjet Palëve lidhur me objektin e kësaj Marrëveshjeje sikurse kërkohet në datën e hyrjes në fuqi. Nëse një çështje nuk është zgjidhur brenda [gjashtëdhjetë (60)] Ditësh Pune (apo brenda një kohe të miratuar nga Palët) nga referimi për zgjidhje në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe Qendrën e Negocimit, secila nga Palët mund të nisë procedurat për arbitrazh ndërkombëtar në përputhje me nenin Error! Reference source not found..
- 18.3 Në mënyrë që të shmangen dyshimet, nuk është qëllim i asnjërës nga Palët që luhatjet në çmimet e tregut me shumicë të energjisë elektrike (në ndryshim nga luhatjet e shkaktuara nga Ndryshimet e Ligjit) të shkaktojnë ndryshime sipas nenit Error! Reference source not found..
- 18.4 Kur ndodh një marrëveshje apo zgjidhje sipas nenit 18.1 ose 18.2 pas Ndryshimit të Ligjit, kjo marrëveshje apo zgjidhje duhet të marrë në konsideratë çdo korigjim të nevojshëm për t'i rivendosur Palët në pozicionin në të cilin do të ishin nëse marrëveshja apo zgjidhja do të kishin ndodhur menjëherë përpara Ndryshimit përkatës të Ligjit.
- 18.5 Në përputhje me dispozitat e tjera të nenit Error! Reference source not found., Palët bien dakord që:
- (a) asnjë Palë nuk mban përgjegjësi për mospërmbushjen e ndonjë detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje që bëhet i ndaluar ose i pamundur për t'u kryer për shkak të Ndryshimit të Ligjit (një rrethanë e tillë do të përbëjë një Ngjarje të Forcës Madhore);
  - (b) në bazë të pikës 18.5(a), Ndryshimi i Ligjit nuk përbën Forcë Madhore, apo i jep të drejtë ndonjëres nga Palët të pezullojë ose përfundojë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;
  - (c) çdo Ndryshim i Ligjit që përbën Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar trajtohet në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**; dhe
  - (d) secila prej tyre do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të minimizuar dhe lehtësuar pasojat e Ndryshimeve të Ligjit për përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

## 19. TRANSFERIMI I PROJEKTIT ME ZGJEDHJE NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

- 19.1 Në rast të Paaftësisë Paguese së Zhvilluesit dhe përfundimit për Arsye Materiale nga Autoriteti Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i kërkojë Zhvilluesit dorëzimin dhe transferimin e gëzimit të plotë dhe të qetë të Vendndodhjes dhe të Impiantit pa pagesë tek

Autoriteti Kontraktues ("**Dorëzimi**"), në përputhje me një plan të dorëzimit që do të nënshkruhet ndërmjet Zhvilluesit dhe Autoritetit Kontraktues, me një inspektim të përbashkët nga Autoriteti Kontraktues dhe Zhvilluesi.

19.2 Në një rast të tillë, Zhvilluesi i transferon pa pagesë Autoritetit Kontraktues:

- (a) çdo dhe të gjitha të drejtat dhe interesat që zotëron në lidhje me Vendndodhjen;
- (b) çdo të drejtë të pasurive të paluajtshme mbi Impiantin e ndërtuar nga Zhvilluesi;
- (c) ndërtesat, makineritë dhe pajisjet që kanë të bëjnë me Impiantin dhe Vendndodhjen;
- (d) të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga çdo kontratë ekzistuese, por që Autoriteti Kontraktues ka të drejtën t'i zgjidhë pa përgjegjësi apo dëmshpërblim dhe Zhvilluesi do të sigurojë që kontratat përkatëse përmbajnë këtë të drejtë të Autoritetit Kontraktues (në të kundërt do të ketë përgjegjësinë për të dëmshpërblyer Autoritetin Kontraktues për të gjitha kostot e arsyeshme shtesë të shkaktuara ndaj Autoritetit Kontraktues si pasojë e zgjidhjes së kontratave të tilla ekzistuese nga ana e Autoritetit Kontraktues;
- (e) librat, dokumentet, regjistrat dhe të dhënat (duke përfshirë çdo garanci të posaçme) që kanë të bëjnë me asetet e përcaktuara në nenin 19.2(a) deri 19.2(d), përfshirë; dhe
- (f) çdo të drejtë të fituar nga Zhvilluesi në përputhje me ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

19.3 Autoriteti Kontraktues pranon Vendndodhjen dhe Impiantin në gjendjen "siç është" në datën e Dorëzimit në përputhje me nenin 19.1, dhe Zhvilluesi nuk ka shpenzime dhe nuk mban përgjegjësi ndaj ndonjë pretendimi të Autoritetit Kontraktues në lidhje me gjendjen e Impiantit apo Vendndodhjes.

## **20. VLERËSIMI I GATISHMËRISË TË TREGUT DHE APLIKIMI CFD PËR PERIUdhËN E TREGTIMIT II**

20.1 Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që:

- (a) një Vlerësim i Gatishmërisë së Tregut është kryer në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Dokumentet e KPP-së dhe Marrëveshjen për Mbështetje sipas kushteve të paracaktuara sipas saj;
- (b) për Periudhën e Tregtimit I përpara përfundimit të një Vlerësimi Pozitiv të Gatishmërisë së Tregut të konfirmuar nga një Deklaratë e Përbashkët e Palëve dhe/ose në rast të një Vlerësimi të Kontestuar të Gatishmërisë së Tregut të zgjidhur sipas kushteve të Marrëveshjes për Mbështetje, mbështetja do të marrë formën e një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë Elektrike të shlyer fizikisht dhe për Periudhën e Tregtimit II pas përfundimit të një Vlerësimi Pozitiv të Gatishmërisë së Tregut të konfirmuar me një Deklaratë të Përbashkët, mbështetja do të marrë formën e një Kontrate për Diferencë të shlyer financiarisht në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen për Mbështetje.
- (c) kalimi nga zbatimi i Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike gjatë Periudhës së Tregtimit I në një Kontratë për Diferencë gjatë Periudhës së Tregtimit II, duke pasur parasysh natyrën e ndryshme të këtyre dy marrëveshjeve, duhet të mbajë të njëjtin ekuilibër ose ekuilibër të ngjashëm të përfitimeve, detyrimeve, rreziqeve dhe përfitimeve ndërmjet Palëve.

20.2 Në veçanti, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që:

- (a) Çmimi i Energjisë Elektrike të shërbejë si çmim i caktuar në një kontratë për diferencën të konvertuar; dhe
- (b) Çmimet e Ditës së Ardhshme të Tregut për orë të ditës do të shërbejnë si çmime referencë të ndryshueshme kundrejt Çmimit të Energjisë Elektrike, për të mundësuar shlyerjen financiare duke iu referuar diferencës ndërmjet çmimit të ndryshueshëm dhe Çmimit të Energjisë Elektrike në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes për Mbështetje.

20.3 Në Periudhën e Tregtimit II, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë që:

- (a) Shitësit do t'i ofrohet opsioni për të lidhur një marrëveshje shërbimesh të tipit *Route to Market* me një Palë Kontraktuese për Mbështetje e Mundësisë së Fundit në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm, dhe e cila ofron shërbime për kalimin e Sasisë së Kontratës në treg për një tarifë të barabartë me [tetëdhjetë (70-80)%] të Çmimit të Referencës për periudhat përkatëse të shlyerjes.
- (b) Shitësit do t'i ofrohet opsioni për të lidhur ose mbajtur marrëveshjen e shërbimeve të balancimit me një Palë Përgjegjëse të Grupit të Balancimit, e cila mund të jetë ose ish-Pala Kontraktuese për Mbështetje ose një palë e tretë e caktuar prej saj ose Pala Kontraktuese për Mbështetje e Mundësisë së Fundit që merr rolin e një Palës Përgjegjëse të Grupit të Balancimit, duke vepruar në përputhje me pikat 7.8 deri në 7.16 dhe nenin 15 të Marrëveshjes për Mbështetje.

## 21. NJOFTIMET

21.1 Çdo njoftim apo komunikim ndërmjet Palëve në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të kryhet në formë të shkruar, dhe konsiderohet i dorëzuar nëse dorëzohet personalisht, me postë të regjistruar me parapagesë, me faks, ose postë elektronike në adresën e marrësit ose (sipas rastit) në numrin e faksit ose adresën e postës elektronike të paraqitur më poshtë (apo në adresën ose numrin faks të njoftuar paraprakisht në përputhje me nenin **Error! Reference source not found.**); *me kusht që*, nëse nuk është dhënë adresë postare apo poste elektronike dhe/ose numri faks për marrjen e njoftimeve, këto njoftime nuk do të dorëzohen nëpërmjet këtyre mënyrave të komunikimit.

21.2 Për qëllimet e këtij neni **Error! Reference source not found.**, të dhënat fillestare të palëve për njoftimet janë si më poshtë:

- (a) Për Autoritetin Kontraktues:

Adresa: [     ]

Tel: [     ]

Adresa e email-it: [     ]

- (b) Për Zhvilluesin:

Adresa: [     ]

Tel: [     ]

Adresa e email-it: [ ]

- 21.3 Në përputhje me nenin 21.4, njoftimet do të konsiderohen të marra:
- (a) në rastin e dorëzimit dorazi, në momentin e dorëzimit;
  - (b) në rastin e dërgesës me postë të regjistruar të parapaguar, në ditën e dytë nga data e postimit;
  - (c) në rastin e dërgesës me faks, në momentin e pranimit nga makina e faksit; *me kusht* që të dërgohet dhe një kopje me postë të parapaguar të klasit të parë brenda [një (1)] Dite Pune; dhe
  - (d) në rastin e dërgesës me postë elektronike, në momentin e mbërritjen së serverin e marrësit dhe nëse dërguesi nuk merr mesazh që ka ndodhur gabim.
- 21.4 Çdo njoftim që konsiderohet si i marrë në një ditë që nuk është Ditë Pune, apo pas orës 17:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në një Ditë Pune, do të konsiderohet se është marrë në orën 09:00 me orën lokale në vendndodhjen e marrësit në Ditën e nesërme të Punës.

## 22. KONFIDENCIALITETI DHE PUBLICITETI

- 22.1 Në zbatim të përjashtimeve të parashikuara në nenet 22.2 dhe 22.3, nga Data e Nënshkrimit deri në përfundimin apo zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje ose brenda një periudhe njëvjeçare pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, asnjë nga Palët nuk nxjerr apo lejon që drejtuesit, punonjësit, agjentët apo kontraktorët e saj të zbulojnë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje ose çdo informacion konfidencial tregtar lidhur me negociatat rreth kësaj Marrëveshjeje të cilat mund t'i jenë bërë të njohura Palës gjatë zhvillimit të negociatave të tilla apo lidhur me veprimet, kontratat, marrëveshjet tregtare apo financiare ose çështje të Palës tjetër, pa marrë miratimin e Palës tjetër.
- 22.2 Kufizimet e vendosura në nenin **Error! Reference source not found.** nuk do të gjejë zbatim në zbulimin e çfarëdo informacioni në rast se:
- (a) del në publik përveç se si rezultat i shkeljes së konfidencialitetit ose që mund të merret nga burime të tjera përveç Palëve;
  - (b) në masën e kërkuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm, informacioni kërkohet t'i jepet çdo personi të autorizuar nga Legjislacioni i Zbatueshëm për ta marrë atë;
  - (c) në masën e kërkuar nga rregullat e ndonjë burse të njohur në të cilën aksionet e Palës që bën zbulimin janë apo propozohen të jenë të kuotuar herë pas here;
  - (d) në masën e kërkuar nga një gjykatë, arbitër apo gjykatë administrative gjatë procedurave në të cilat Pala që zbulon informacionin është palë;
  - (e) jepet nga njëra Palë për cilindo nga drejtuesit apo punonjësit e saj ose te ndonjë Shoqëri e lidhur apo drejtues ose punonjës të Shoqërisë së lidhur, të cilëve iu nevojitet informacioni për t'iu mundësuar atyre të kryejnë detyrat e tyre, *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit të barasvlershme me ato në nenin **Error! Reference source not found.**;
  - (f) jepet nga njëra Palë për konsulentët, bankat, financierët, siguresit ose këshilltarët e saj ose për ndonjë prej Shoqërive të lidhura apo konsulentëve, bankave, financierëve,

siguruesve ose këshilltarëve të Shoqërisë së lidhur, *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit të barazvlefshme me ato të nenin **Error! Reference source not found.**; ose

- (g) jepet nga Zhvilluesi për një investitor të mundshëm *në mirëbesim*, ose blerës të aksioneve, Zhvilluesi ose asetet që përbëjnë Impiantin (ose konsulentët e tyre profesionalë, bankat, financierët ose këshilltarët), *me kusht* që këta persona të zbatojnë detyrimet e konfidencialitetit të barazvlefshme me ato të nenit **Error! Reference source not found.**

- 22.3 Pa paragjykuar të drejtat ose mjetet e tjera që mund të ketë një Palë, Palët pranojnë dhe bien dakord që dëmet nuk do të jenë një korrigjim i përshtatshëm për asnjë shkelje të nenit **Error! Reference source not found.** dhe korrigjimet juridike, performanca e veçantë dhe lehtësira të tjera janë të përshtatshme për çdo kërcënim apo shkelje të kësaj dispozite.

### **23. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 23.1 Kjo Marrëveshje dhe çfarëdo mosmarrëveshje apo pretendim që rrjedhin nga apo lidhet me të (duke përfshirë pretendimet jokontraktuale) rregullohet nga dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

- 23.2 Çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga apo lidhet me këtë Marrëveshje (duke përfshirë ndonjë dyshim rreth ekzistencës, vlefshmërisë ose zgjidhjes së saj) i referohet fillimisht drejtuesit të secilës Palë, që do të takohen në mirëbesim për ta zgjidhur mosmarrëveshjen brenda [tridhjetë (30)] Ditëve Pune, që nga referimi i mosmarrëveshjes.

- 23.3 Në rastet kur kjo Marrëveshje përcakton se një mosmarrëveshje duhet t'i referohen Qendrës së Zgjidhjes dhe Negocimit të Mosmarrëveshjeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për t'u zgjidhur ose kur Palët bien dakord, mosmarrëveshja mund të referohet nga cilado Palë te Qendra e Zgjidhjes dhe Negocimit të Mosmarrëveshjeve e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe zgjidhet në pajtim me Aktin Procedural 2018/5/EnC të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në rast se mosmarrëveshja lidhet me përcaktimin e një Ngjarje të Forcës Madhore sipas paragrafit (vi) të nenit 1 në lidhje me vlerësimin e thelluar të ndikimit në mjedis apo për llogaritjen e dëmeve të likuiduara sipas nenit 6.9 dhe 6.10, secila nga Palët mund të paraqesë çështjen për zgjidhje para Ekspertit në pajtim me Aktin Procedural 2018/5/EnC të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë duke njoftuar Palën Kontraktuese me shkrim për kërkesën e saj për zgjidhje të mosmarrëveshjes me Ekspert duke përcaktuar emrin e Ekspertit të propozuar. Nëse Palët nuk bien dakord për caktimin e Ekspertit që do të kryejë detyrën dhe/apo kushtet e caktimit të Ekspertit brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune nga njoftimi në lidhje me këtë, Eksperti do të caktohet (me kërkesë të secilës prej Palëve) nga Sekretariati i Qendrës për Ndërmjetësim dhe Negocim të Komunitetit të Energjisë në pajtim me Aktin Procedural 2018/5/EnC të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Në rast përcaktimi nga Eksperti sipas parashikimeve të këtij neni do të zbatohen dispozitat e më poshtme:

- (a) përveç rastit të mashtrimit apo gabimi të dukshëm, përcaktimi i Ekspertit sipas parashikimeve të këtij neni është përfundimtar dhe detyrues për Palët dhe i ekzekutueshëm si detyrimet e tyre kontraktuale;
- (b) të gjitha çështjet në lidhje me përcaktimin e Ekspertit do të kryhen, dhe vendimi i Ekspertit do të bëhet me shkrim, në gjuhën Angleze; dhe
- (c) secila nga Palët do të mbulojë të gjitha shpenzimet e veta dhe një të dytën e shpenzimeve të Ekspertit dhe të çdo konsulenti të pavarur të Ekspertit përveçse kur Eksperti (në diskrecionin e tij/saj) vendos ndryshe.



- 23.4 Në përputhje me pikat 23.2 dhe 23.3, çdo pretendim që vjen nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje (duke përfshirë mosmarrëveshjet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje apo detyrimeve jokontraktuale që vijnë nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje) referohen dhe zgjidhen përfundimisht nëpërmjet arbitrazhit nën rregullat e arbitrazhit të [Dhomës Ndërkombëtare të Tregtimit (ICC)] (“**Rregullat**”). Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga [tre (3)] arbitra të caktuar në përputhje me Rregullat. Selia e arbitrazhit do të jetë në [Vjenë, Austri]. Gjuha e procedimit të arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
- 23.5 Asnjëra Palë nuk pezullon apo përjashtohet nga përmbushja e detyrimeve përkatëse, duke përfshirë detyrime për pagesa që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, deri kur çdo mosmarrëveshje të jetë zgjidhur përfundimisht sipas mënyrës së përmendur në këtë dokument.
- 23.6 Lindja e çdo mosmarrëveshjeje apo pezullimi i procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nuk ndikon te detyrimet e Palëve për të kryer pagesat në zbatim të kësaj Marrëveshjeje. Një shumë e tillë konsiderohet për t’u paguar dhe shlyhet plotësisht në pritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Rakordimi i shumave të paguara kryhet menjëherë pas zgjidhjes përfundimtare të mosmarrëveshjes dhe duke u bazuar në të.

## **24. DISPOZITA TË NDRYSHME**

- 24.1 Asnjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk parashikon dëmshpërblim për humbje, dëme, kosto apo shuma të tjera për të cilat Pala e dëmtuar është dëmshpërblyer për të njëjtën humbje, dëm, kosto apo shumë të përcaktuar në ndonjërin nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes për Mbështetje apo procedurat e sigurimit.
- 24.2 Në rastet kur secila Palë i jep Palës tjetër lëshim, tolerancë, ose shtyrje kohe, ose nuk zbaton apo ushtron asnjë prej të drejtave ose mjeteve të veta, ose vonon, të drejtat dhe mjetet ligjore të asaj Pale lidhur me këtë Marrëveshje nuk pakësohen, dorëzohen, ose shuhen.
- 24.3 Nëse njëra Palë heq dorë nga ndonjë shkelje e kësaj Marrëveshjeje, gjithsesi do t’i duhet ta zbatojë më vonë atë dispozitë dhe heqja dorë nuk konsiderohet si heqje dorë nga shkelje pasuese të asaj apo një tjetër dispozite.
- 24.4 Në rast se cilado pjesë e kësaj Marrëveshjeje gjatë një kohe kurdo (duke përfshirë një ose më shumë nene të kësaj Marrëveshjeje apo nën pika ose pikë apo një pjesë e një ose më shumë prej këtyre neneve) do të jete apo bëhet a pavlefshme ose ndryshe nuk është më e vlefshme ose e zbatueshme për çfarëdo arsye në kuadër të Legjislacionit të Zbatueshëm, ajo pjesë hiqet nga kjo Marrëveshje, pjesa e mbetur e kësaj Marrëveshjeje do të lexohet në përputhje me rrethanat dhe vlefshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohen apo kufizohen për shkak të asaj pjesë të hequr.
- 24.5 Secila Palë bie dakord që të bëjë dhe kryejë herë pas here veprime të tjera apo të mëtejshme dhe të zbatojë dhe ofrojë instrumente çfarëdo apo të tjera të ngjashme siç mund të kërkohet me ligj apo me arsye nga Pala tjetër në mënyrë që të vendosen, ruhen dhe mbrohen të drejtat dhe mjetet ligjore të Palës tjetër dhe që të zbatohet dhe të përmbushet synimi dhe qëllimi i kësaj Marrëveshjeje.
- 24.6 Në çfarëdo kohe pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Palët sigurojnë dhe bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që çdo palë e tretë e nevojshme i zbaton këto dokumente dhe vepron në mënyrë të atillë që ajo Palë të përfitojë plotësisht nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
- 24.7 Kjo Marrëveshje përfshin tërësinë e marrëveshjeve ndërmjet Palëve lidhur me objektin e saj. Secila nga palët heq dorë në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar nga çdo e drejtë që mund të ketë për të pretenduar dëme, ose për ta anuluar këtë Marrëveshje për shkak të shkeljes

së një garancie që nuk përmbahet shprehimisht në këtë Marrëveshje, apo për shkak të ndonjë keqpërfaqësimi qoftë i përfshirë në këtë Marrëveshje ose jo, duke përjashtuar rastin nëse ky keqpërfaqësim ka qenë mashtrim.

- 24.8 Një person që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë cilindo punonjës, oficer, agjent, përfaqësues apo nënkontraktor të cilësdo palë) nuk ka të drejtë të bëjë të detyrueshme asnjë nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje.
- 24.9 Asgjë në këtë Marrëveshje nuk krijon apo konsiderohet se krijon një partneritet, ndërmarrje të përbashkët apo një marrëdhënie punonjës-punëmarrës apo shoqëri kryesore-agjent ndërmjet Palëve dhe asnjë punonjës i një Palë nuk duhet të jetë apo të bëhet punonjës i Palës tjetër.
- 24.10 Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, asnjëra Palë nuk ka të drejtë të marrë dëmshpërblim apo të ngrejë një pretendim në kuadër të kësaj Marrëveshjeje lidhur me humbje që ka pësuar nëse ka marrë dëmshpërblim për atë humbje në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes për Mbështetje, të ardhurave të sigurimit ose të të tjerave. Asnjë Palë nuk ka të drejtë të zhëmtohet për dëmet e pësuar apo të përfitojë shtyrje kohore, pagesë, rimbursim, kompensim apo zhëmtim më shumë se njëherë për të njëjtën humbje.
- 24.11 Autoriteti Kontraktues dhe Zhvilluesi bien dakord të bashkëpunojnë për të lehtësuar zbatimin e Projektit.
- 24.12 Palët sigurojnë që kjo Marrëveshje, brenda tridhjetë [(30) Ditësh Pune] nga Data e Hyrjes në Fuqi, të jetë regjistruar në Agjencinë Shtetëtare të Kadastrës në Republikën e Shqipërisë.
- 24.13 Marrëveshja është hartuar në tri (3) kopje në gjuhën shqipe, dhe tri (3) kopje të tjera në gjuhën angleze (në rast të mosmarrëveshjeve, do të ketë përparësi versioni në shqip).

## FAQJA E NËNSHKRIMIT

Për

**Palen Mbeshtetese/Autoriteti Kontraktues**

.....

Pozicionin [    ]

Për

[    ]

.....

[    ]

## **SHTOJCA 1: IMPIANTI DHE VENDNDODHJA**

### **Pjesa 1: Impianti**

### **Pjesa 2: Vendndodhja**

Faqja pasardhëse

## SHTOJCA 2: SIGURIMI I MARRËVESHJES

Sigurimi i Marrëveshjes:

1. është një garanci bankare e pakushtëzuar dhe e pakthyeshme bazuar në termat dhe kushtet që përputhen me kriteret e përcaktuar në nenet 2 deri në 9 dhe ka formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues;
2. është për llogari të Zhvilluesit dhe në emër të Autoritetit Kontraktues si përfitues;
3. hyn në fuqi në një datë jo më vonë se Data e Afatit Përfundimtar të Kushteve Paraprake dhe mbahet nga Zhvilluesi deri në datën më të hershme dyzet e pesë (45) Ditë Pune pas:
  - 3.1 Kolaudimit të Impiantit në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe
  - 3.2 zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje;
4. përcaktohet në monedhën Euro dhe ka një shumë minimale të disponueshme për tërheqje në vlerën [xxxxxxx Euro për MW për Kapacitetin total të një Projekti];
5. tërhiqet në momentin e kërkesës së parë vetëm nëpërmjet dorëzimit të një certificate tërheqjeje të lëshuesi ku njoftohet ky i fundit se Zhvilluesi ka shkelur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;
6. përfshin procedura të zbatueshme dhe praktike të tërheqjes sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit Kontraktues, *me kusht* që të mos përmbajë asnjë kusht për tërheqjen përveç konfirmimit të lëshuesit që certifikatat e kërkuara të tërheqjes që duhet të dorëzohen për tërheqjen të jetë në përputhje me kriteret e Sigurimit të Kontratës;
7. lëshohet nga një bankë ose institucion tjetër financiar që është i pranueshëm për Autoritetin Kontraktues dhe që ndodhet në një vend të pranueshëm për Autoritetin Kontraktues;
8. mundëson tërheqje të shumëfishta të përfituesit; dhe
9. në rast të një kërkesë garancie, deklaron shprehimisht që iu nënshtrohet “Rregullave Uniforme për Kërkesë Garancitë”, dhe, deri në atë masë që përputhet me “Rregullat Uniforme për Kërkesë Garancie”, legjislacionin shqiptar.

### **SHTOJCA 3: OFERTA**

Faqja pasardhëse

**SHTOJCA 4: MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE ME KUSHTET E MARRËVESHJES SË  
BLERJES SË ENERGJISË PËR PERIUDHËN TË TREGTIMIT I DHE KONTRATËS PËR  
DIFERENCË PËR PERIUDHËN E TREGTIMIT II**

## **SHTOJCA 5: TESTET E KOLAUDIMIT**



## **SHTOJCA 6: MARRËVESHJA E LIDHJES**